

ENGJËLL ANGONI

PASTHIRRMAT NË GJUHËN E SOTME SHQIPE*

Vëzhgimet në gjuhën e folur e të shkruar, sidomos në gjuhën e veprave të shkrimtarëve tanë të sotëm, të bindin për rolin e rëndësishëm të pasthirmave si njësi gjuhësore shprehëse dhe shumë të shkurtëra. Sido që paraqesin interes të dukshëm teorik e praktik, ato mbeten një nga njësitë gjuhësore më pak të studjuara në gjuhën shqipe. Pasthirrma është e vetmja pjesë e ligjëratës, për të cilën mungon një trajtim i plotë e me prirje normative. Objekt studimesh a trajtesash të veçanta ato janë bërë rrallë¹. Si kategori e veçantë leksiko-gramatikore pasthirrmat janë dalluar e trajtuar në gramatikat e gjuhës shqipe, shkollore e joshkollore, nga vendas e të huaj, por

*) Ky punim është një studim tërësor për pasthirrmat në gjuhën e sotme shqipe, pjesa e dytë e të cilit do të botohet në Nr. 1, 1974 të revistës sonë. (Redaksia).

1) Simon Shuteriqi, *Ortografia e pasthirmës*, Buletini i Institutit të Shkencave, Nr. 4, 1949, f. 85-86. Në këtë artikull shfaqet mendimi për drejtshkrimin e disa pasthirmave.

Vladimir Buben, *Flektované interjekce a imperativni partikule v Albanštině*, 1955, Universitas Carolina, Philologica, vol. 1, Nr. 2, f. 185-206. Në këtë studim autori vë në dukje se në gjuhën shqipe «pasthirrmat urdhërore dhe pjesëzat e ndryshme thirrrore ose urdhërore nganjëherë përdoren me forma foljore. Si rrjedhim kur u drejtohem disa personave ose një personi të vetëm, të cilit i drejtohem me «ju» ato marrin kuptimin e numrit shumës. Ndryshe nga gjuhët e tjera indoevropiane, ku një dukuri e tillë ndeshet rrallë ose më saktë vetëm si përjashtim, në gjuhën shqipe vërehet mjaft shpesh». Si pasthirrma dhe pjesëza të tilla që mund të përdoren me mbaresën e shumësit -ni, ai përmend «hajde-hajdeni, o shokë; haj-të hajni me gjithë fëmijët; ea, eja, jakë pasthirrma që përdoren si forma urdhërore të foljes vete dhe vij, në numër shumës eani, ejani, jakëni; na-nani; këtu-këtuni; prapa-prapani, dale-daleni, pjesëza mohuese mos-mosni, of-ofni, o djem; hesht-heshtni, aman-amani, bravo-bravoni». Autori trajton gjithashtu «mbiemrin lum, lumth, që merr mbaresën e pjesores së shkuar i lum-ur, i lumtur dhe për analogji me mënyrën dëshirore paraqitet gjithashtu me formën foljore të lumtë», «formulat e përshëndetjes tungjatjeta, lamtumir, mirdita, mirë mëngjes, mirë mbrëma, puna mbarë, udha mbarë, që mund të marrin gjithashtu mbaresën -ni kur folësi u drejtohet disa personave» dhe «rasën thirrrore shumës burra-burrani, e cila ka humbur kuptimin përkatës dhe është shndërruar në pasthirrmë, me të cilën i drejtohem dikuj për veprim».

Max Lambertz, *Zur albanischen Umgangssprache*, Lingua Poznaniensis, vol. II, Poznan, 1958, f. 133 v. në kapitullin «Interiektionen» pasqyron gjerësisht pasthirrmat e së folmes së Gjirokastrës, nga të cilat një pjesë janë të mbarë shqipes;

E. Angoni, *Pasthirrmat*, «Arësimi popullor», 3, 1962. Autori në këtë shkrim, ndër-mjet të tjerave, shtjellon veçoritë leksikore e gramatikore të pasthirmave dhe for-

zakonisht shumë shkurt². Në përshtatje me natyrën e shkollës, kjo kategori leksiko-gramatikore është shtjelluar pak më gjerë nga prof. Shaban Demiraj³. Por në këto gramatika nuk janë përfshirë të gjitha çështjet që dalin për këtë pjesë të ligjëratës, gjë që shpjegohet me synimet e caktuara për to — gramatikat e hartuara nga shqiptarët kanë shërbyer si tekste mësimore, ndërsa gramatikat e hartuara nga të huajt kanë karakter përshkrues — informativ. Nga ana tjetër, mjaft çështje nuk janë shtjelluar gjithmonë si dhe sa duhet. Si rrjedhim numri i problemeve që presin zgjidhje është relativisht i gjerë. Ndërmjet të tjerave mund të përmendim: a) veçoritë leksikore e gramatikore të pasthirmave, b) formimi i pasthirmave, c) pasthirrat e huazuara, ç) klasifikimi i pasthirmave sipas kuptimit, d) vendi dhe funksioni i pasthirmave, dh) njësitë onomatopeike, funksioni dhe mundësitë fjalëformuese të tyre etj. Shtruarja dhe zgjidhja e këtyre pro-

mimin e tyre, bën ndarjen e pasthirmave në grupe sipas kuptimit dhe dallon pasthirrat nga fjalët onomatopeike. Shfaqet gjithashtu mendimi se disa pasthirra (o, more, moj, mori, ore, ori), kur shoqërojnë thirroret si fjalë zakonisht proklitike, shërbejnë si pjesëza përforcuese (përkatësisht pjesëza thirrëse, term i përdorur për to nga M. Çeliku në artikullin *Disa vërejtje kritike për gramatikat shkollore*, «Lëndët shoqërore në shkollë», 1969, 1, f. 14, dhe *Thirrori në gjuhën letrare shqipe*, kapitull i pregatitur për tekstin «Gramatika e gjuhës shqipe»). Mendimet që kemi para-shtruar për këto çështje, zakonisht në mënyrë sintetike, me ndonjë ndryshim jo thelbësor mbeten të vlefshme, prandaj, si rregull, nuk ndalemi rreth tyre në kapitullin «Vështrim mbi trajtimin e deritanishëm të pasthirmave të gjuhës shqipe». Natyrisht në studimin që po paraqesim çështjet gjejnë pasqyrim më të plotë e më të hollësishëm.

E. Angoni, *Disa çështje të drejtshkrimit të pjesëzave dhe të pasthirmave*. «Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe». II, 1973, f. 385-395. Instituti i Gjuhësisë e i Letërsisë. Në këtë kumtesë trajtohen: a) shkrimi i pjesëzave dhe i pasthirmave bashkë dhe ndaras, b) shkrimi i pjesëzave dhe i pasthirmave bashkë dhe me vizë në mes, c) shkrimi i tingujve që shqiptohen të zgjatur dhe i bashkëtingëllores *h* te pasthirrat.

Gjovalin Shkurtaç, *Një vështrim mbi përdorimin e pasthirmave dhe pjesëzave thirrëse në të folmet e Malësisë së Madhe*. «Studime filologjike», 1, 1972, f. 113-115. Sikurse pohon autori «qëllimi i këtij artikulli nuk është të sjellë pasthirra që s'nji-hen fare, por të thellohet dija për përdorimet dhe vlerat semantike të atyre pasthirmave që dalin më rëndom në këto të folme».

2) Fr. M. Da Lecce, *Osservazioni grammaticali nella lingua albanese*, Roma, 1716; J. G. Hahn, *Albanesische Studien*, Jena, 1854; K. Kristoforidhi, *Gramatikë tës alvanikës glossës*, Kostantinopojë, 1882; Sami H. Frashëri, *Shkronjëtoje e gjuhës shqip*, Bukuresht, 1886; Gj. Pekmezi, *Grammatik der Albanesischen Sprache*, Wien, 1908; Anton M. Xanoni, *Gramatika shqyp*, Shkodër, 1909; Gustav Weigand, *Albanesische grammatik in sudgegischen Dialekt*, Leipzig, 1913; G. Mikeli, *Gramatika e giuhes shqype*, Shkodër, 1916; Koço Tasi, *Grammatikë e gjuhës shqype*, Vlorë, 1923; Ilo Dilo Sheperi, *Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë, 1927; F. Cordignano, *Lingua albanese*, Milano, 1931; Aleksandër Xhuvani, *Libri i gjuhës shqipe*, pjesa e dytë, për klasat e nalta të Fillores dhe të parat e Qytetses, Tiranë, 1939; Osman Myderrizi, *Gramatika e Re e Shqipes*, për shkollat e mesme, vëllimi I, Tiranë, 1944; Kostaq Cipo, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1942; L. Dodbiba — S. Spasse, *Gramatika e gjuhës shqipe për shkollat shtatëvjeçare*, Tiranë, 1953; Shaban Demiraj — Nikoleta Cikuli, *Gramatika e gjuhës shqipe për shkollën pedagogjike*, Tiranë, 1971, pjesa I; Petër Elezi — Lirak Dodbiba, *Gramatika e gjuhës shqipe*, morfologji, II, për kl. VI të shkollës 8-vjeçare, Tiranë, 1971; Fatmir Agalliu — Anastas Dodi — Islam Dizdari, *Libri i gjuhës shqipe*, për klasën VII të shkollës 8-vjeçare, Tiranë, 1972. SHENIM: Në gramatikën e A. Dozonit, *Manuel de la langue chkipe ou albanaise*, Paris, 1879, pasthirrat nuk trajtohen fare.

3) Shaban Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, dispensë, pjesa II, USHT, 1970.

blemeve, mbështetur në një material të pasur faktik, mendojmë se është me mjaft interes në thellimin e studimit të kësaj kategorie leksiko-gramatikore. Ky studim besojmë se do të ndihmojë në qartësimin e mëtejshëm të problemeve, të cilat kanë mbetur ende të pazgjidhura në një mënyrë të kënaqshme.

Vështrim mbi trajtimin e deritanishëm të pasthirrmave të gjuhës shqipe

Duke marrë parasysh gjendjen e studimeve të pasthirrmave të gjuhës shqipe, objekt i vështrimit tonë do të jenë kryesisht gramatikat e gjuhës shqipe, që janë shkruar nga autorë vendës e të huaj.

Disa autorë të gramatikave tona kanë përdorur për pasthirrmat edhe ndonjë term tjetër. Kështu, p.sh., Sami H. Frashëri⁴ përdor termin *thirrje*, Anton M. Xanoni⁵ i quan *ndërmiet-hiedha* a *interiekcion* (nga terma latine *interiectio-onis*, që do të thotë «ajo që hidhet në mes të ligjëratës»), G. Mikeli⁶ i quan *interjekcion*, Koço Tasi⁷ i emërton *klithje*, ndërsa Kostaq Cipo⁸ përdor termin *epifonema* (nga terma greke *epiphonema*). Ai që i ka pagëzuar fjalët e kësaj kategorie leksiko-gramatikore me termin «Pasthirrma» është Aleksandër Xhuvani⁹.

Nëpër gramatikat e ndryshme janë trajtuar, ku më shumë e ku më pak këto çështje rreth pasthirrmave: a) përkufizimi, b) klasifikimi, c) formimi, ç) fjalët onomatopeike¹⁰.

a) Sami Frashëri¹¹, i pari autor vendës që hartoi një gramatikë të shqipes në gjuhën shqipe, ka dhënë këtë përkufizim për pasthirrmat: «Thirrjeja është një fjalë e-papërkthyer, invariable) a një zë që rëfen gas, helme, çudi etj.». Ky përkufizim nuk e përfshin të gjithë përmbajtjen e kësaj pjese të ligjëratës, megjithatë autori ka dhënë dy veçori të pasthirrmave: a) mundësinë për të shprehur ndjenja, b) karakterin e pandryshueshëm. Deri në këto 10-15 vitet e fundit, ky

4) Sami H. Frashëri, vepër e cituar, f. 133.

5) Anton M. Xanoni, vepër e cituar, 166.

6) G. Mikeli, vepër e cituar, f. 124.

7) Koço Tasi, vepër e cituar, f. 12.

8) Kostaq Cipo, vepër e cituar, f. 186.

9) Aleksandër Xhuvani, *Libri i gjuhës shqip*, pjesa II, f. 129-130, 1920. Në botimin e vitit 1919 ai përdor termin «Thirrme». (Shih. Aleksandër Xhuvani, *Libri i gjuhës shqipe*, pjesa I, 1919, f. 53 Elbasan).

10) Në gramatikën e Hahnit dhe në atë të F. Cordignanos nuk trajtohet asnjëra nga këto çështje, sepse autorët janë mjaftuar me një listë pasthirrmash. Hahni përmend këto pasthirrma, të cilat ai i quan «Thirrje» (ausrufungen): *ā!* se kështu thua; ndalu të më shofsh, ndashti më shef!; *ā!* Sikur vërte thua?; *Āāh!* ç'bëra!; *ē!ē!* (mjaft, mjaft); *ēē!* fol si të duash!; *ē!* ç'janë ato që thua!; *ēh!* dhe ti! — geg. *ē!* ne ti!; *ē!* ç'do baish?; *ē!* sikur të jetë; *ē!* ç'thua ti?; *ē!* atje ishte?! *hēle!* *hele hele!* — geg. *elē!* kështu thua!; *i!* ndashti ukujtushe!; *ō!ō!ō!* (për ndjenjë gëzimi); *ō hō hōç!*; *hōi!* *hōi!* si qeneka këjo dunja! *hāi!* *hāi!* ta paskësham fjetune! *ōū!* ose *ōā!* ç'bërre!; *ōi!*; *ōi!* s'dërohetë!; *u bubū!* ose *upupū* — tosk. edhe *bobo* o *bobo* — un e vorfna!; *ō!* — tosk. edhe *ōi!* — më dhem!; *ōf!* ose *ōfsh!* — *ōfsh!* o perndi! (shiko J. G. Han, vepër e cituar, f. 105). F. Cordignano jep këta shembuj mbi përdorimin e pasthirrmave, që i ka marrë nga gramatika e Vaso Pashës «Grammaire albanaise»: *Oh,* ç'mot i mirë, sot n'dimen!; *Eh!* aj tha kështu.; *Ah!* i mjeri un! *Aji!* po m'dhem këma.; *Uh;* nuk mund t'duroj më!; *Pyh!* mos e prek me dorë.; *Ehj!* kush asht?; *Morë* burr, kua po shkon?; *Mori* (moj) grue, kah po vjen? (shiko F. Cordignano, *Lingua albanese* (dialeto ghego, Milano, 1931, f. 308).

11) Sami H. Frashëri, vepër e cituar, f. 133.

përkufizim ruhet, në vija të përgjithshme, në të gjitha gramatikat e shqipes, hartuar nga autorë vendës. Këta autorë nuk kanë sjellë ndonjë përmirësim të qenësishëm. Sikurse Samiu, vërejnë zakonisht te pasthirrmat fjalë, zëra a tinguj që shërbejnë për të shprehur a treguar ndjenja. Ndryshe nga Samiu këta autorë nuk përmendin një nga veçoritë kryesore të pasthirrmave — karakterin e pandryshueshëm. Ja përkufizimet që jepen në gramatikat përkatëse:

*Anton M. Xanoni*¹² «Thohen ndërmi-t-hiedha a interiekcione do zana a fjalë qi lshohen andei kndei tui kuvendë; e kuer njimend çohen prei fundit t'zemers s'prekun prei gazmendit, dhimtes, tutës, idhnimit a ç'do t'dindunit tjetër kan hije t'madhe fort.»;

*G. Mikeli*¹³ «T'ndiemet t'ona t'permrëndsme, prekun t'thuejsh prejë gazmendit, dhimtës, idhnimit, tutes e t'perbuzunit a po edhe prejë t'kercnuemit, dishirit e t'bindunit, i tregojmë shpesh herë përjashta tuej lshue do zâne a fjalë, qi i thrrasim interjekcion.»;

*Koço Tasi*¹⁴ «Fjalët, të cilat shfaqin një pësim të shpirtit tonë quhen klithje.»;

*Aleksandër Xhuvani*¹⁵ «Pasthirrma quhen fjalët, me të cilat rrëfejme ndjenjat e rrepta të shpirtit, si dhimsuni, të dhimtun, mallëngjim, gëzim, etj.»;

*Osman Myderrizi*¹⁶ «Pasthirrmë quhet fjala që na shërben për me shprehë ndjenjat e forta të shpirtit, si dhimbje, dhimsuni, idhnim, gëzim, çudi etj.»;

*Kostaq Cipo*¹⁷ «Epifonema — pasthirrma është fjalë a tingull nga nonjë herë britmë e ulurimë që del nga shpellat e krahërorit për të shprehur një ndjenjë të ngrohtë, një përshtypje të shpejtë»;

*Lirak Dodbiba — Sterjo Spasse*¹⁸ «Pasthirrmat janë fjalë a zëra që gufojnë nga zëmra dhe tregojnë gëzim, hidhërim, habi, dëshpërim etj.».

Sic mund të vihet re pa vështirësi, përkufizimet vërtet janë formuluar në mënyra të ndryshme, por në thelb mbetet përkufizimi i Samiut për pasthirrmat. Ndryshime të ndjeshme i bën përkufizimit tradicional për pasthirrmat prof. Shaban Demiraj.¹⁹ Ai ka dhënë një përkufizim më të plotë për to: «Pasthirrmat janë tinguj, fjalë a grupe fjalësh, që shërbejnë për të shprehur ndjenja të folësit pa i emëruar ato, ose për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve». Pra nënvizon se: 1. pasthirrmat shërbejnë për të shprehur ndjenja të folësit, por pa i emëruar ato, dhe 2. mund të shërbejnë jo vetëm për të shprehur ndjenja, por edhe për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve. Këto ndryshime e zgjerime që i janë bërë përkufizimit të pasthirrmave shënojnë një hap të mirë e të rëndësishëm përpara, megjithatë mendojmë se edhe

12) Anton M. Xanoni, *vepër e cituar*, f. 166.

13) G. Mikeli, *vepër e cituar*, f. 124.

14) Koço Tasi, *vepër e cituar*, f. 112.

15) Aleksandër Xhuvani, *vepër e cituar*, pjesa II, Tiranë, 1939, f. 129.

16) Osman Myderrizi, *vepër e cituar*, f. 297.

17) Kostaq Cipo, *vepër e cituar*, f. 186.

18) Lirak Dodbiba — Sterjo Spasse, *vepër e cituar*, f. 221-222.

19) Shaban Demiraj, *vepër e cituar*, f. 294.

ky përkufizim nuk është aq i plotë e i saktë, sepse, krahas të tjerave, a) pasthirrmat nuk emërtojnë jo vetëm kur shërbejnë për të shprehur ndjenja, por edhe kur shërbejnë për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve a të dëgjonjësve (përkatesisht për të shprehur dëshirën a vullnetin e folësit), b) pasthirrmat, kur nuk shërbejnë për të shprehur ndjenja, përdoren jo aq për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve a të dëgjonjësve se sa për të shprehur dëshirën a vullnetin e folësit, c) nuk përmendet një nga veçoritë dalluese të pasthirrmave — karakteri i pandryshueshëm i tyre.

Përmirësimet që i bën përkufizimit të pasthirrmave prof. Shaban Demiraj janë pasqyruar më vonë në të gjitha gramatikat shkollore të shkollave tona 8-vjeçare dhe të disa shkollave të mesme social-kulturale, që pregatisin mësues²⁰.

b) Nga autorët vendës, përpjekjen e parë për klasifikimin e pasthirrmave sipas kuptimit e ka bërë K. Kristoforidhi²¹, ndërsa nga të huajt Francesco M. Da Lecce²². Pas tyre ndarjen e pasthirrmave në

20) Petër Elezi — Lirak Dodbiba, *vepër e cituar*, botim i vitit 1971, f. 168: «Pasthirrmat janë tinguj, fjalë ose një grup fjalësh që shërbejnë për të shprehur një ndjenjë të folësit ose për të tërhequr vëmendjen e dëgjonjësve», po këta autorë, në botimet e mëparshme kanë dhënë këtë përkufizim: «Pasthirrma është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës. Kjo mund të jetë një tingull a një grup tingujsh, një fjalë a një grup fjalësh që shërbejnë për të treguar një ndjenjë shpirtërore, d.m.th. një *gëzim, hidhërim, dëshpërim, mërzitje* etj. Si pasthirrma merren edhe fjalët *more, o, ore, oj, moj, mori, ori*, etj. që vehen para emrave dhe përemrave të rasës thirrrore»; (shih: P. Elezi — L. Dodbiba, *vepër e cituar*, botim i vitit 1959, f. 351); Shaban Demiraj — Nikoleta Cikuli, *Gramatika e gjuhës shqipe për shkollën pedagogjike*, pjesa I, 1971, f. 325: «Pasthirrmat janë tinguj, fjalë dhe grupe fjalësh, që shërbejnë për të shprehur ndjenja të folësit dhe për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesve»; F. Agalliu — A. Dedi — I. Dizdari, *vepër e cituar*, f. 82: «Pasthirrmat janë tinguj, fjalë dhe grupe fjalësh, që shërbejnë për të shprehur ndjenja të folësit, ose për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesve. Ato janë pjesë të pandryshueshme të ligjëratës». Ndryshe nga të tjerët, dhe ashtu si Sami Frashëri, këta autorë, në përkufizim nënvizojnë me të drejtë se pasthirrmat janë pjesë të pandryshueshme të ligjëratës.

SHËNIM: në gramatikat e tjera, hartuar nga autorë vendës e të huaj, nuk jepet asnjë përkufizim për pasthirrmat.

21) K. Kristoforidhi, *vepër e cituar*, f. 165, si vë në dukje se «pasthirrmat dhe shprehjet pasthirrmore janë të llojeve të ndryshme, meqë edhe emocionet dhe ndjenjat e shpirtit janë të ndryshme», shënon disa prej tyre: «thirrëse: *o ti!, ore!, more!* (mashkullore), *moj!, mori!, ori!* (femërore); 2) indinjuese: *ah! oh!, of!, upupú!, ububú!, mjeri unë!, mjeri ti!*; 3) të qeshur: *há-há-há!*; 4) habitore: *opopó!*; 5) admiruese: *uá!*; *ou!*; 6) *Uhá!* kur shprehim admirim ose tallje; 7) *Hópa!* për fillimin e veprimit; 8) qetësuese: *tyt! hesht!, pusho!*; 9) shmangëse, larguese: *shporru!*; 10) lënduese: të lumtë!» Pas këtyre përmend si shprehje pasthirrmore: «*Ruajna zot! Qoftë larg! Pro o Zot! Ore ku je! T'u ngjatë jeta! Krisht! Qëndro! Lidhur!* etj.».

22) Francesco M. Da Lecce, *vepër e cituar*, f. 202-203, pasi vë në dukje se pasthirrmat shërbejnë «për të shprehur afektet dhe ndjenjat e shpirtit, sikurse na e tregon emri» dallon (duke u nisur nga «domethënia» e pasthirrmës) pasthirrma për: «lëvdim, si: *i paa shok; gëzim, si: i lumi un për ty;* përbuzje, si *cpor, haide, hiq, hik;* dhimbje, si: *veme: sod, e sod;* kënaqësi; si *aferim, brè brè;* vajtim, si: *he he: keq për mue;* psherëtimë, si: *eeh i madhi zot;* habi, si: *hai hai, laabdia;* tallje, si: *huu, keqiaan;* heshtje, si: *hesht;* frikë, si: *hei: sot, e sod;* gjendje të vështirë, si: *i mieri;* dëbim me urrejtje, si: *tretu;* mallkim, si: *haide dreq.*

grupe sipas kuptimit e vëmë re te gramatika e Gustav Weigandit²³ dhe te ajo e Koço Tasit.²⁴ Por këta autorë nuk puqen me njëri tjetrin si nga pikëpamja e numrit të grupeve, ashtu edhe, në shumë raste, nga pikëpamja e llojit të grupeve dhe e përmbajtjes së secilit grup. Pa nënvleftësuar kontributin përkatës, duhet vënë në dukje se këta autorë nuk kanë mundur të na japin një ndarje të plotë e të saktë të pasthirmave në grupe sipas kuptimit. Ndërmjet të tjerave, në këto grupe kanë përfshirë (përveç Da Lecces) të ashtuquajturat fjalë onomatopeike, si dhe disa shprehje a fjalë të kategorive të ndryshme leksiko-gramatikore, kryesisht emra e folje, që në të vërtetë s'janë pasthirma (K. Kristoforidhi: *hesht, pusho, shporru, qëndro*; Da Lecce: *çpor, hiq, hesht, tretu, i pa shok*, etj.; G. Weigand: *çudi, hesht* etj.; K. Tasi: *mos* etj.). Në grupet përkatëse të pasthirmave janë përfshirë një numër i kufizuar fjalësh e shprehjesh pasthirmore, madje, në ndonjë rast, grupi përkatës përbëhet nga një pasthirmë e vetme. Në mënyrë të veçantë duhet vënë në dukje se këta autorë për ndarjen e pasthirmave në grupe nuk janë mbështetur gjithmonë në kuptimet e përdorimet kryesore, prandaj, krahas të tjerave, disa grupe janë të tepërta a të paqëlluara. (p.sh. K. Kristoforidhi — grupet e pasthirmave admiruese, shmangëse, mërguese, K. Tasi — grupi i pasthirmave ndaliake etj.), e njëjta pasthirmë është vendosur në grupe të ndryshme (p.sh. K. Kristoforidhi pasthirmën *of* e vlerëson si indinjuese, ndërsa G. Weigand e quan pasthirmë hidhërimi a dhimbjeje etj.), pasthirma sinonime vendosen në grupe të ndryshme (p.sh. K. Kristoforidhi pasthirmën *ububu* e vlerëson indinjuese, ndërsa pasthirmën *opopo* e quan habitore) etj.

Ndryshe i trajton pasthirmat sipas kuptimit Ilo Dilo Sheperi. Duke u mbështetur në kuptimin më të përgjithshëm të tyre ai i ndan në dy grupe të mëdha, ose, siç shprehet vetë, «Pasthirmat janë dy farësh a) thirrrore, me të cilat i drejtohem tjetrit (vetes së dytë) ose e thërresim: *o, more, moj*; b) pasthirma me të cilat shfaqim ndjenja të shpyrtit, si habitje, gëzim, hidhërim, dhembje, zemërim, frikë etj. P.sh. *O! bobo! bubu! ba! vaj! ha ha! oh! aman! urra* etj.»²⁵ Kështu ai hedh një hap tjetër të rëndësishëm përpara, sepse, përveç të tjerave, krijon një bazë të re e të menduar mirë për një ndarje të mëtejshme të pasthirmave sipas kuptimit, më të hollësishme e të qëlluar. Këtë e ka realizuar në një shkallë të dukshme prof. Shaban Demiraj, i cili

23) Gustav Weigand, *vepër e cituar*, f. 99-100, dallon pasthirma me anën e të cilave shprehim thirrje: *or!, mre!, moré* (për burrat); *móri!, mōj!* (për gratë); *çudi: bre!, tshudi!, au!*; gëzim: *ohoho! aferim* (tk), *bravo, lum për atë*; qetësim: *hesht!*; hidhërim, dhimbje: *of!, uf!, medet* (tk), *mjer për mū; murgu un! kÿkjÿ un! mjer për botën! mre korb!* Përmend si pasthirma por pa i vendosur në ndonjë grup fjalët *nja!, nji!, shif!, shiko!* Në fund rreshton edhe dy grupe, në njërin dallon pasthirmat turke, ndërsa në tjetrin ato që shërbejnë për të imituar zëra kafshësh dhe sende e fenomene të tjera të realitetit objektiv.

24) Koço Tasi, *vepër e cituar*, f. 12, dallon pasthirma «çudiake» (*po-po, ou, u, bubu, moré*); *vajake* (*oh, ah, mjer, bobo*); *qesharake* (*a-a-a*), *ndaliake* (*mos*) dhe *thir-jake* (*o, ore*).

25) Ilo Dilo Sheperi, *vepër e cituar*, f. 125. Duke bërë këtë ndarje të pasthirmave në grupe, autori është njëherazi edhe i pari që te pasthirma vëren atë pjesë të ligjëratës e cila shërben jo vetëm për të shprehur ndjenja, por edhe për shërbime të tjera, përkatësisht për t'iu drejtuar tjetrit ose për ta thirrur.

dallon gjithashtu dy grupe kryesore: 1) pasthirrma që shërbejnë për të shprehur ndjenjat e folësit, 2) pasthirrma që shërbejnë për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve²⁶. Pra, ai ka ndryshuar rendin e grupeve që përcaktohen nga I. D. Sheperi. Në grupin e parë vendos pasthirmat që shërbejnë për të shprehur ndjenja. Kjo është e drejtë, sepse pasthirmat, në radhë të parë, shërbejnë për të shprehur ndjenja. Nga ana tjetër numri i pasthirmave që shërbejnë për të shprehur ndjenja është më i madh se pasthirmat që përfshihen në grupin tjetër. Prof. Shaban Demiraj, duke plotësuar një zbrazëti tjetër të klasifikimit që na ka dhënë I. D. Sheperi, pasthirmat e secilit grup i ka ndarë në disa nëngrupe. Pasthirmat e grupit të parë i ndan në: 1) pasthirrma që shprehin ndjenja gëzimi, kënaqësie, aprovimi etj. (*o! urra! të lumtë! bravo!*), 2) pasthirrma që shprehin ndjenja hidhërimi, dëshpërimi, mërzitjeje, pakënaqësie etj. (*ah! oh! bobo! opopo! uf! of! olele! dreq o punë! djall o punë! qyqja! korba!* etj.), ndërsa pasthirmat e grupit të dytë i ndan në 1) pasthirrma thirrjeje, lutjeje etj. (*o! ore! more! moj! mori! hej! aman! të keqen!* etj.), 2) pasthirrma urdhëri, nxitjeje etj. (*sst! sust! hajde! o burra-ni*), 3) pasthirrma përsëritjeje, falenderimi etj. (*tungjatjeta! mirëmëngjes! lamtumirë! mirupafshim! mirseardhët! udh'e mbarë! falënderit! t'ù rrit ndera!* etj.²⁷

Pa dyshim, ky klasifikim që u bën prof. Shaban Demiraj pasthirmave sipas kuptimit, përbën një hap tjetër të rëndësishëm përpara. Ndërkaq duhet nënvizuar se ndërsa ndarja që u bën pasthirmave të grupit të dytë, na duket e përshtatshme dhe e pranueshme, prandaj edhe, me ndonjë ndryshim të vogël, do t'i përmbahemi përgjithësisht në studimin tonë, ndarja që u bën pasthirmave të grupit të parë, na duket e pamjaftueshme, sepse kufizohet vetëm në dy nëngrupe a klasë, nga të cilat e dyta thuhet se i përfshin të gjitha pasthirmat që shprehin ndjenja, pra thuhet se të gjitha pasthirmat e grupit përkatës.

Klasifikimit që na ka dhënë prof. Shaban Demiraj i janë përmbajtur thuhet plotësisht *Engjëll Angoni*²⁸, *Shaban Demiraj — Nikoleta Cikuli*²⁹, *F. Agalliu-A. Dodi-I. Dizdari*³⁰. Këta të fundit i kanë ndarë pasthirmat në tri grupe kryesore, pra kanë shtuar një grup — të tretin. Grupi i parë dhe grupi i dytë me nëngrupet përkatëse përputhen me ato që jep prof. Shaban Demiraj. Në grupin e tretë ata kanë vendosur «pasthirmat që janë fjalë onomatopeike, d.m.th. fjalë që u shëmbëlajnë zhurmave, a zërave që nxjerrin kafshët, sendet dhe fenomenet e

26) Shaban Demiraj, *vepër e cituar*, f. 295.

27) Shaban Demiraj, *po aty*, 295-297.

28) Engjëll Angoni, *vepër e cituar*, f. 102-107.

29) Shaban Demiraj — Nikoleta Cikuli, *vepër e cituar*, f. 325.

30) F. Agalliu — A. Dodi — I. Dizdari, *vepër e cituar*, f. 82. Ndryshe i kanë ndarë pasthirmat në grupe sipas kuptimit Petër Elezi — Lirak Dodbiba në gramatikën e hartuar po për këtë kategori shkolle. Duke u mbështetur kryesisht në traditën para I. D. Sheperit ata dallojnë 1) pasthirrma që tregojnë gëzim, kënaqësi dhe urime (*O! për të mirë! Mirëmëngjes! Mirëdita! Tungjatjeta!*); 2) pasthirrma që tregojnë pikëllim ose mërzi (*oh, vaj-vaj, oh, uf*); 3) pasthirrma që tregojnë urrejtje ose mallkim (*ptu*); 4) pasthirrma që tregojnë habi ose thirrje (*more, bre*); 5) pasthirrma që tregojnë nxitje (*zemër, burrani, sst, kape, çit, moj*) — Shih Petër Elezi — Lirak Dodbiba, *vepër e cituar*, f. 168.

natyrës, përshembull: *be-be, mu-mu, hi-hi-hi, ham-ham, mjau, ty-ty-ty, iring-tring, fërr-fërr, bamb-bam, bum-bum* etj.»

c) Në disa gramatika e në ndonjë studim pasthirrmat janë klasifikuar edhe nga pikëpamja e mënyrave të formimit. Përpjekjen e parë e gjejmë te gramatika e Anton M. Xanonit, i cili dallon: 1) pasthirrma të thjeshta, kur janë formuar nga një fjalë e vetme, dhe 2) pasthirrma të bashkangjitura, kur janë formuar nga më shumë se një fjalë.³¹ Por shembujt që jep, janë të kufizuar dhe nuk janë ndarë për secilin grup, si rrjedhim nuk dallohet qartë se ç'përfshihet në grupin e pasthirrmave të thjeshta dhe ç'përfshihet në grupin e pasthirrmave të bashkangjitura. Kështu, p.sh. ndërmjet të tjerave, nuk le shteg për të kuptuar se ku përfshihen pasthirrmat që janë formuar nga pjesë të ndryshme të ligjëratës dhe pasthirrmat që janë formuar nga bashkimi i dy a më shumë fjalëve në një fjalë të vetme. Duke u mbështetur kryesisht në shembujt që jepen për pasthirrmat, mund të supozohet që në pasthirrmat fjalë të thjeshta përfshin ato që janë formuar nga tingujt të veçantë ose grupe tingujsh dhe nga fjalë të pjesëve të ndryshme të ligjëratës, ndërsa në të bashkangjiturat ato që janë formuar nga bashkime të qëndrueshme frazeologjike ose nga përngjitja e dy a më shumë fjalëve në një fjalë të vetme.

Këtë qëndrim mbajnë edhe Simon Shuteriqi e L. Dodbiba-S.Spasse, por pasthirrmat e pathjeshta Simon Shuteriqi i quan të përngjitura,³² ndërsa L.Dodbiba-S.Spasse i quajnë shprehje thirrore³³.

Kostaq Cipo i ndan dhe i emërton ndryshe pasthirrmat. Ai dallon: pasthirrma *tinguj*, pasthirrma *fjalë të thjeshta* dhe *shprehje epifonematike*.³⁴ duke veçuar kështu, si të një natyre krejt të veçantë, pasthirrmat *tinguj* nga pasthirrmat *fjalë të thjeshta*. Në pasthirrmat *fjalë të thjeshta*, me sa kuptohet, përfshin pasthirrmat që janë formuar nga fjalë të pjesëve të ndryshme të ligjëratës si dhe fjalët-pasthirrma të huazuara, ndërsa me shprehje epifonematike ka parasysh pasthirrmat e formuara nga bashkime të qëndrueshme frazeologjike dhe pasthirrmat që janë formuar nga bashkimi i dy a më shumë fjalëve në një

31) Anton M. Xanoni, *vepër e cituar*, f. 166, Pasthirrmat «janë t'simplert n'u baishin me një fjalë t'vetme; janë t'bashkangjiturat n'u baishin me fjalë ma se një, si me thanë: *ah! eh! oh! oh t'lumtë! ai sot e sot*».

32) Simon Shuteriqi, *vepër e cituar*, f. 85-86: «Pasthirrmat janë të thjeshta e të bashkangjitura. Të thjeshta: *o, or, ori, oj, mori, moj, more, mor, mre, ej, yrra, bre, lele, uf, of, ofsh, ah, uh, vdiq, shkova, ika, mbarova, plaç, u mbyç, mjerë, vaj*. Të bashkangjitura: *lele, lele; uf, uf; of of; ofsh, ofsh; të lumtë; riej-na, Zot; e gjeç prej Zotit në vënd (plaç në vënd); zorrët (të dalshin zorrët); t'u humbtë shpirti, të raftë pika; ha, ha, ha, ha; pa, pa, pa, pa, pa; pu, pu, pu, pu*».

33) L. Dodbiba — S. Spasse, *vepër e cituar*, 1953, f. 222: «Pasthirrmat quhen të thjeshta, kur sajohen prej një fjale të vetme si p.sh. *O! More! Mori! Moj! Bre! Mos! Uf! Ah! Fap! Hop (Hopa)! Tyt! Sst! Forca! Plaç! Aman! Shporru! Shëndet! Gëzuash! Gëzuar! Ua! Ii!* etj. Quhen shprehje pasthirrmore kur përbëhen prej disa fjalësh, si këto: *Paç faqen e bardh! U lumtë krahu! Vafsh e ardhç shëndoshë! Rri me shëndet! O burrani!* etj.

34) Kostaq Cipo, *vepër e cituar*, f. 186-187: «Epifonemat ndahen në tinguj, në fjalë të thjeshta dhe në shprehje epifonematike. Epifonemat më të thjeshta i gjejmë te tingujt e te fjalët monosilabike». Si të tilla ai përmend: *aa!; a!, ah!, aaah!, e!, ee!, eh!, eh!, ii!, ol!, hej!, ua!, oi!, o ho hoç!, hë!, haj! haj!, hoj! hoj!, sst!, tyt!, pthu!, fët!, hopp!, uuuf!, aman!, o burra!*, ndërsa si shprehje epifonematike vlerëson: «*qoftë larg!, tungjatjeta!, të mirë mbeç!, lamtumirë!, me shëndet!, të lumtë!, lumthi ti!*».

fjalë të vetme. Pra, autori, pa të drejtë, veçon pasthirrmat tinguj nga pasthirrmat fjalë të thjeshta, dhe, ashtu si autorët e mësipërm, bashkon në një grup të vetëm lokucionet pasthirrmore me pasthirrmat që janë formuar nga bashkimi i dy o më shumë fjalëve në një fjalë të vetme.

Nga sa mund të vërehet pa vështirësi, autorët kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për ndarjen e pasthirrmave në grupe dhe për emërtimin e tyre. Mendojmë se nga pikëpamja e përbërjes strukturore edhe pasthirrmat ashtu si të gjitha fjalët e gjuhës shqipe, pjesë të ndryshueshme e të pandryshueshme të ligjëratës, është e përshtatshme të ndahen në tri grupe: a) të thjeshta, b) të përbëra, c) lokucione. Në këtë mënyrë, krahas të tjerave, kapërcehen edhe luhatjet terminologjike që vërehen në klasifikimin e fjalëve të gjuhës shqipe nga pikëpamja e përbërjes strukturore nëpër gramatika të shqipes e në studime të ndryshme³⁵. Pasthirrma fjalë të thjeshta janë të gjitha pasthirrmat e parme, të formuara nga tinguj të veçantë ose nga grupe tingujsh (*o, u, au, ou, ua, oh, uh, bah, hop, sus* etj.), pasthirrmat e prejar dhura prej fjalësh të tjera të thjeshta (me konversion nga pjesë të ndryshme të ligjëratës: *o burra, forca, e zeza* etj.) si dhe disa fjalë-pasthirrma të huazuara (*aman, alo, bis, bravo, urra* etj.). Janë fjalë të përbëra pasthirrmat e formuara nga përngjitja e dy a më shumë fjalëve të veçanta (*obobo, ububu, tungjatjeta, lamtumirë* etj.) Lokucionet pasthirrmore përbëhen prej dy a më shumë fjalësh (të pabashkuara në një fjalë), të cilat kanë një kuptim të vetëm dhe kryejnë funksionin e një pasthirrme (të lumtë, t'u bëfsha, djall o punë etj.).

Prof. Shaban Demiraj i ka klasifikuar pasthirrmat sipas prejar dhjes. Nga kjo pikëpamje i ndan në dy grupe: 1) të mirëfillta, «kur nuk kanë dalë nga ndonjë pjesë tjetër e ligjëratës as nga ndonjë fjali» dhe 2) të pamirëfillta, «kur janë formuar nga ndonjë pjesë tjetër e ligjëratës ose nga ndonjë fjali». ³⁶ Ky klasifikim na duket më i përshtatshëm për grupimin e pasthirrmave sipas mënyrave të formimit, sepse, krahas të tjerave, në përbërjen e pasthirrmave nuk vërehen elemente fjalëformimi (parashtesa a prapashtesa), prandaj, duke iu përmbajtur në përgjithësi, pasthirrmat do t'i ndajmë gjithashtu në dy grupe, por duke i emërtuar ndryshe, përkatësisht: 1. pasthirrma të parme, që nuk kanë dalë nga ndonjë pjesë tjetër e ligjëratës (janë tingujt të veçantë ose grupe tingujsh), dhe 2. pasthirrma të prejar dhura, që vijnë prej fjalësh të tjera.

ç) Të ashtuquajturat fjalë onomatopeike zakonisht përfshihen te pasthirrmat. Këtë qëndrim kanë mbajtur edhe shumica e autorëve të

35) Emil Lafe, *Mbi disa terma të klasifikimit të fjalëve sipas përbërjes strukturore dhe sipas fjalëformimit*, «Studime filologjike», 1, 1972, f. 127-130.

36) Shaban Demiraj, *vepër e cituar*, f. 295, «Nga pikëpamja e prejar dhjes pasthirrmat mund të jenë të mirëfillta dhe të pamirëfillta. Janë të mirëfillta ato pasthirrma që nuk kanë dalë nga ndonjë pjesë tjetër e ligjëratës as nga ndonjë fjali. Të tilla janë pasthirrmat *O! Oh! U! Ububu! Obobo! Uf!* etj. Këto pasthirrma janë tinguj të thjeshtë ose grupe tingujsh, ose lokucione. P.sh. *O! U! A!* etj. *Of! Ah! Uf! Oji-oji! Medet! Ububu!* etj. *Oh medet, oji-oji* etj. Pasthirrma të pamirëfillta janë ato që janë formuar nga ndonjë pjesë tjetër e ligjëratës ose nga ndonjë fjali. P.sh. *Forca! O burra! Dreq o punë! Hajde, dreq! Tungjatjeta!* (nga t'u ngjattë jeta!), *mirëmëngjes!* etj.»

gramatikave të gjuhës shqipe, të cilët, ndonëse në përkufizimet a rregullat që japin zakonisht për pasthirmat, nuk i trajtojnë fare fjalët onomatopeike, ndërmjet shembujve, ose, në ndonjë rast, ndërmjet ushtrimeve për pasthirmat futin edhe ndonjë fjalë onomatopeike³⁷. Vetëm në tri gramatika të gjuhës shqipe trajtohen më gjerë dhe mbahet qëndrim i prerë për to: në gramatikën e hartuar nga Shaban Demiraj — Nikoleta Cikuli³⁸, në gramatikën e hartuar nga F. Agalliu — A. Dodi — I. Dizdari³⁹ dhe në gramatikën e hartuar nga Shaban Demiraj⁴⁰. Në dy të parat autorët pohojnë se fjalët onomatopeike janë pasthirmat⁴¹, ndërsa në gramatikën e hartuar nga prof. Shaban Demiraj ky mendim kundërshtohet — ai nënvizon se «fjalët onomatopeike në të vërtetë nuk janë pasthirmat, sepse nuk shërbejnë për të shprehur ndonjë ndjenjë të folësit, as për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve. Këto u ngjajnë pasthirmave vetëm nga ana tingullore»⁴². Qëndrimi që mban prof. Shaban Demiraj ndaj të ashtuquajturave fjalë onomatopeike është i drejtë, sidoqë ato janë të ngjashme me pasthirmat jo vetëm nga forma (nga përbërja tingullore), por edhe në disa drejtime të tjera, nuk emërtojnë, përdoren në formë të ngurosur (janë të pandryshueshme), nuk kanë elemente fjalëformuese në përbërjen e tyre, janë të vetmuara nga pikëpamja sintaksore dhe shqiptohen me intonacion të veçantë. Megjithatë ato ndryshojnë shumë nga pasthirmat, sepse, në radhë të parë, nuk shërbejnë për të shprehur ndjenja, dëshirën a vullnetin e folësit, por shërbejnë për të riprodhuar tingujt, zërat, zhurmata, britmat, klithmat etj. të sendeve e të fenomeneve të ndryshme të realitetit objektiv. Rrjedhimisht intonacioni me të cilin ato shqiptohen nuk varet nga ndjenja përkatëse (siç ndodh me pasthirmat), por

37) Kostandin Kristoforidhi, *vepër e cituar*, f. 165, ndërmjet ushtrimeve veçon edhe *hà-hà-hà!*; Sami H. Frashëri, *vepër e cituar*, f. 133 ndërmjet shembujve përfshin si pasthirmat *haha, fiu, frap, pësh, pty*; Gustav Weigand, *vepër e cituar*, f. 100, ndërmjet pasthirmave përfshin edhe ato, që shërbejnë për të imituar «zërat e kafshëve»: *bÿ* (lopa, viçi), *úâ* (gomari), *be* (delja), *mjâu* (macja); të shtënë: *bam!* bubullima: *bû*; të goditurit; *dang!*; rrëzimi: *plou!*; të trokiturit: *traktrak!*; ora: *tiktik*: Koço Tasi, *vepër e cituar*, f. 12, ndërmjet grupeve të pasthirmave dallon edhe «klithjen qesharake «a-a-a»»; Ilo Dilo Sheperi dhe Osman Myderrizi, *vepër e cituar*, përkatësisht f. 125 dhe 279, përmendin ndërmjet shembujve si pasthirmat *ha ha*; Kostaq Cipo, *vepër e cituar*, f. 187, përmend si pasthirmat *ha ha* dhe *pthu*; Petër Elezi — Lirak Dodbiba, *vepër e cituar*, f. 170-173, trajtojnë si pasthirmat, nëpërmjet ushtrimeve, *taf*; *ha-ha-ha!* *kam-kum!* *taf-tuf!* *ty-ty-ty!*

38) Shaban Demiraj—Nikoleta Cikuli, *vepër e cituar*, f. 327.

39) F. Agalliu—A. Dodi—I. Dizdari, *vepër e cituar*, f. 82.

40) Shaban Demiraj, *vepër e cituar*, f. 297.

41) Shaban Demiraj—Nikoleta Cikuli, *vepër e cituar*, f. 327, vënë në dukje se «... në klasën e pasthirmave futen zakonisht edhe fjalët onomatopeike, d.m.th., ato fjalë me të cilat imitohen tingujt e kafshëve, të sendeve e të fenomeneve të natyrës, si p.sh. *mjau, ki-ki-kuuu, muuu, hum-hum, ty-ty-ty, fër-fër-fër, bum-bum*»;

F. Agalliu — A. Dodi—I. Dizdari, *vepër e cituar*, f. 82. Fjalët e onomatopeike vlerësohen si pasthirmat dhe janë përfshirë në një nga të tri grupet kryesore të tyre (në klasifikimin që u bëhet pasthirmave sipas kuptimit).

42) Shaban Demiraj, *vepër e cituar*, f. 297.

SHËNIM: Fjalët onomatopeike nuk përmenden e nuk ndeshen fare në gramatikat që kanë hartuar: Francesco M. Da Lecce, J. G. Hahn, Gjergj Pekmezi, Anton M. Xanoni, G. Mikeli, F. Cordignano, Aleksandër Xhuvani dhe Lirak Dodbiba — Sterjo Spasse. (shih veprat e cituara përkatëse).

nga tingujt, zërat, zhurma, britmat, klithmat etj. të sendeve e të fenomeneve të ndryshme të realitetit objektiv që riprodhohen. Ndryshe nga pasthirrmat që kanë përbërje fonetike të përcaktuar, të ashtuquajturat fjalë onomatopeike kanë përbërje fonetike të papërcaktuar a të pangulitur, sepse, ndërmjet të tjerave, tingulli, zëri, zhurma, britma a klithma e sendit të dhënë të realitetit objektiv, që përftohet në të njëjtat rrethana, mund të perceptohet e riprodhohet në mënyra të ndryshme nga njerëz të ndryshëm. Përveç kësaj, shpesh, përbërja tingullore e ndryshme e formimeve onomatopeike pasqyron tingujt, zërat, zhurmat, britmat, klithmat etj. që përftohen ndryshe te i njëjti send i dhënë i realitetit objektiv, ose te sendet e një fare, sidomos në rrethana të ndryshme. Natyrisht, edhe kur, në disa raste, përbërja fonetike është pak a shumë e përcaktuar (*ciu* — zogu, *miau* — macja, *kuak* — bretkosa etj.), riprodhimi që u bëhet tingujve, zërave, zhurmave, britmave, klithmave etj. të sendeve e fenomeneve të ndryshme të realitetit objektiv është gjithmonë i përafërt dhe asnjëherë i plotë e i përpiktë. Ja pse na duket plotësisht i drejtë mendimi se fjalët onomatopeike nuk janë pasthirrma. Ato shërbejnë si mjete me karakter shprehës përshkrues për të pasqyruar realitetin objektiv. Përdoren shpesh, sidomos në letërsinë artistike, me qëllim që të shtohet fuqia shprehëse dhe ndikimi te lexuesi. Ato nuk janë as pasthirrma, as fjalë, sepse nuk kanë as kuptim leksikor, as kuptim gramatikor. Prandaj, ndryshe nga pasthirrmat, ato, me të drejtë, nuk përfshihen nëpër fjalorët e gjuhës, sidoqë numri i tyre është i madh e i larmishëm. Për t'i dalluar nga fjalët ne kemi përdorur termin njësi onomatopeike. Pa dyshim, në varësi nga konteksti, ato mund të përdoren si fjalë të një kategorie të caktuar leksiko-gramatikore. Në këtë rast kemi konversion, ato nuk shërbejnë për të riprodhuar tingujt, zërat, zhurmën, britmat, klithmat etj. të sendeve e fenomeneve të ndryshme të realitetit objektiv, por marrin veçoritë leksikore e gramatikore të fjalëve të pjesës përkatëse të ligjëratës. P.sh. Mbi oxhak dëgjohet *tik-taku* monoton i orës së vjetër. (Gj. Zheji, Tregimet, 122); *Hajde-hajde*, kulaçi i math i djellit kërcen përpjetë, ngjitet në qiell e bëhet djellë, çan retë e magjitë që ka endur shtriga e del i kuq si furrë. (M. Kuteli, Xinxifilua, f. 179).

PERKUFIZIMI DHE VEÇORITË LEKSIKORE E GRAMATIKORE

Pasthirrma është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që shërben për të shprehur ndjenjat, dëshirën a vullnetin e folësit, por pa i emërtuar konkretisht ato.

Pasthirrmat zënë një vend të veçantë ndërmjet pjesëve të tjera të ligjëratës, sepse ndryshojnë shumë prej tyre si nga pikëpamja leksikore, ashtu edhe nga pikëpamja gramatikore. Karakteristikat kryesore të pasthirrmave janë këto:

1. Pasthirrmat janë fjalë që nuk emërtojnë. P.sh.

— Këtu jemi në det. E ndjen shijen e ujit të kripur? — *Oh*, pse kështu qenka deti! tha me habi. (N. Prifti, Pika, 11); Unë mbylla sytë i lebetitur: — *Bobo*, dallëndyshja! (Dh. Shuteriqi, Gurnecka, 13); — «*Shëëët*» — u tha një infermiere, që erdhi të ndërronte plagën.

Mos i folni se e dëmtoni kur flet. (P. Marko, *Hasta*, 420).

Pasthirrmat *Oh*, *Bobo*, *Shëëët* shërbejnë në këta shembuj për të shprehur drejtpërdrejt përkatësisht çudi, tmerr, urdhër (për vendosjen e qetësisë), por nuk i emërtojnë këto ndjenja a dëshira të folësit, sepse nuk kanë funksion emërtues. Janë pikërisht emrat përkatës si çudi, qetësi, tmerr etj. që shërbejnë për t'i emërtuar këto ndjenja a dëshira të folësit. P.sh.

— Pleqtë dinë gojëdhënat e dynjasë. — *Çudi! Çudi!* (Gj Zheji, *Pupagjeli*, 43); *Eqremi* — U nisën? *Shabani* — Po. *Eqremi* — Kur? *Shabani* — Tashti, s'ka shumë... *Eqremi* — *Çudi!* (*Banakierit*) A ka ndonjë vend për të fjetur këtu usta? (K. Blushi, *Çatia e të gjithëve*, 39); — *Oh! Oh! Tmerr! Tmerr!* (F. Gjata, *Përmbysja*, 399); *Tmerr!* Sikur të vijnë — thesh *Byk Zagora* duke flakur tej një çallmë dervishi që e kish vënë në kokë në vend të kapellës së tij. (F. Gjata, *Përmbysja*, 401).

Veçoria që kanë pasthirrmat për të shprehur drejtpërdrejt ndjenjat, dëshirën a vullnetin e folësit, i bën ato të dallohen edhe nga fjalë të tjera, semantika e të cilave ka lidhje me shprehjen e ndjenjave, sepse te këto të fundit ndjenja nuk shprehet drejtpërdrejt, por është objekt i mendimit, që tregohet nga fjala, ashtu si me fjalën mund të tregohet çdo send ose ngjarje tjetër e realitetit objektiv. P.sh. foljet *çuditem*, *habitem*, *gëzohem*, *hesht* etj. *Krahaso*:

— *Çuditem* se si nuk i erdhi një ftesë e tillë shokut *Zylo*, — thashë unë. (D. Agolli, *Shkëlqimi*, 31); *Gëzohem*, — tha ai dhe shtoi: — *Shoku Q.* s'ishte përgatitur mirë. (D. Agolli, *Shkëlqimi* 19); — *Hesht*, budalla! — thirri si i tërbuar komandanti. — S'të kam dhënë leje të flasësh. *Kasneç!* (F. Topi, *Fitorja*, 48).

Edhe kur pasthirrmat e kanë prejardhjen nga fjalë të pjesëve të ndryshme të ligjëratës, nuk emërtojnë. P.sh.

— *Qyqja*, vdiq *Nekija!* — Duke u dredhur ajo doli në oborr e thirri fqinjët (R. Nepravishta, *Pelikanët*, II, 176); *O burra*, shoku *Perlat*, se na e kaluan fëmijët, (F. Gjata, *Brezat*, 198).

Pasthirrma «*Qyqja*», e cila për nga prejardhja është emër, përdoret për të shprehur një ndjenjë, dëshpërim, ndërsa pasthirrma «*O burra*», e cila gjithashtu për nga prejardhja është emër, përdoret për të shprehur nxitje për kryerjen e një veprimi; megjithatë, si njëra, ashtu edhe tjetra, në këto raste nuk kanë funksion emërtues.

2. Pasthirrmat hyjnë në grupin e pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës. Ato nuk kanë asnjë nga kategoritë gramatikore të pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës, kështu që as lakohen, as zgjedhohen. Pasthirrmat mbeten të pandryshuara, në formë të ngurosur, edhe kur janë formuar prej pjesësh të ndryshme të ligjëratës. P.sh. pasthirrmat *forca* (*forcani*), *o burra* (*o burrani*), *qyqja*, *e zeza* etj. përdoren në forma gramatikore të ngurosura.

3. Për nga ndërtimi pasthirrmat janë fjalë që në përbërjen e tyre nuk kanë elemente fjalëformuese (*parashtesa* e *prapashtesa*).

4. Pasthirrmat janë fjalë të vetmuara nga pikëpamja sintaksore, sepse nuk lidhen sintaktikisht me pjesët e tjera të fjalisë dhe nuk janë gjymtyrë të saj.

5. Pasthirrmat janë karakteristike për gjuhën e folur, prandaj kuptimi i tyre shpesh qartësohet kur shqiptohen me intonacion të

veçantë. Intonacioni përkatës, në varësi nga rrethanat e vërteta të të folurit a konteksti, i shoqëruar nganjëherë edhe me gjest e mimikë, u jep atyre mundësinë që të shprehin ndjenja të ndryshme dhe nuancat e tyre. Në gjuhën e folur intonacioni mjafton që të na japë vlerën për një «ah!» ose për një «oh!» Në gjuhën e shkruar pasthirrmat interpretohen vetëm në kontekst. Por në kontekst interpretimi i tyre nuk është gjithmonë i sigurtë, sidomos kur janë të vetmuara. Prandaj, p.sh., në replikat e një teksti të shkruar për teatër, autorit i duhet shpesh të saktësojë ndërmjet parantezash vlerën që dëshiron t'i japë pasthirrmës dhe mimikën përkatëse. P.sh.

Sherua — Njëri nga ata më tha: S'e kafshon dot këtë mollë se je plak e të mbeten dhëmbët. Haxhiu — (me habi) A! (N. Prifti, Dasmë, 67); Dhimitri — Punon me ne në stacionin e pompimit, në Linas, ka mbaruar teknikumin e naftës këtu në qytet... Eugjeni — (me tallje) Bre?! (S. Pitarka, Heronjtë, 40); Dom Gjoni (Mrikës) A ta thashë, moj Mrikë!... Ja, Lulashi, tashti!... Mrika: Sikur nuk patë edhe ti dëshirë të rrijshe me të! Dom Gjoni (shikon me inat Mrikën) He...he (shikon me radhë të gjithë). (K. Jakova, Dom Gjoni, 89).

Pasthirrmat si shprehje të afekteve, duhen dalluar nga britmat e pavullnetshme të njeriut, që nuk hyjnë në gjuhë si mjete komunikimi. Sipas traditës, te pasthirrmat janë përfshirë edhe tingujt a britmat që nxjerr njeriu, kur reagon ndaj ngacmimeve të ndryshme, p.sh., kur shqipton «brr» gjatë shfaqjes së refleksit të të ftohtit, kur pështyn «pthu», sepse në gojë i bie diçka e idhët, ose bërtet «of», «uf», «a» etj., për shkak të sëmundjes etj. Tinguj e britma të tilla që shprehin reflekse, janë rezultat i reaktionit të pavullnetshëm të organizmit ndaj ngacmimeve të jashtme e të brendshme dhe nuk duhen vlerësuar si fjalë të gjuhës. Këta tinguj e britma dalin në mënyrë të pavullnetshme nga njeriu, pavarësisht se ka a nuk ka dëgjues, dhe, në ndonjë rast, kundra dëshirës së vetës që lëshon britmën. Mund të ndodhë që për shkak të këtyre tingujve a britmave njeriu ta ndjejë veten edhe të turpëruar. P.sh:

Khaketa prej lëkure me peliçe te qafa, dukej sikur do t'i çahej. —Brrrr! Sa ftohtë! — ia bëri. (A. Kanini, Mbi një platformë betoni, Tregime, 79); — Oooh! rënkoi plaka e lotët iu derdhën ndër mollzat e zbeta. (Dh. Xhuvani, Kambana, 111).

Përkundrazi, pasthirrmat janë mjete të posaçme, të sajuara nergut për shprehjen e ndjenjave dhe janë pjesë përbërëse e fjalorit të një gjuhe. Çdo gjuhë ka në përbërjen e saj pasthirrma, që përdoren e kuptohen prej të gjithëve. Prandaj pasthirrmat duke qenë shprehëse të ndjenjave, të dëshirave a të vullnetit të një njeriu të veçantë, janë njëkohësisht të kuptueshme e të pranueshme nga të gjithë ata që flasin një gjuhë të dhënë si mjete të shprehjes së emocioneve.

Po tingujt që shprehin reflekse, mund të përdoren jo rrallë edhe për të shprehur ndjenja. Kështu, p.sh. «pthu» nuk është pasthirrmë, kur pështyjmë me të vërtetë, por kur këta tinguj përdoren për të shprehur zemërim, përbuzje, krupë etj. atëherë janë fjalë-pasthirrma emocionale. Krahaso, p.sh.

— *Pthu*, — pështyu Qazimi në hajat pa asnjë shkak. A. Abdihoxha, Një vjeshtë, 133); — *Ptu*, ai rekomentim idiotik!... Ç'punë e marrë ndër ma të marrat. (S. Sulejmani, Njerëzit, 63).

Në shembullin e parë «*Pthu*» nuk është pasthirrmë, ndërsa në shembullin e dytë është pasthirrmë, sepse shërben për të shprehur një ndjenjë.

KLASIFIKIMI I PASTHIRRMAVE SIPAS PREJARDHJES

Pasthirrmat janë një grup fjalësh jo aq produktiv, megjithatë shtohen me formime të reja nga tingujt e të folurit dhe pjesët e tjera të ligjëratës. Nga pikëpamja e prejardhjes mund të ndahen në dy grupe: 1) pasthirrma të parme dhe 2) pasthirrma të prejardhura. Të parme janë ato pasthirrma që nuk kanë dalë nga ndonjë pjesë tjetër e ligjëratës. Këto pasthirrma mund të jenë tinguj të veçantë ose grupe tingujsh. Të prejardhura janë ato pasthirrma që vijnë prej pjesësh të tjera të ligjëratës ose janë formuar nga bashkimi i dy a më shumë fjalëve në një fjalë të përngjitur a në një lokucion.

Pasthirrmat e grupit të parë kanë këtë përbërje:

a) çdo tingull zanor (shqiptohet i shkurtër ose me gjatësi të ndryshme në varësi nga konteksti dhe rrethanat e të folurit), p.sh.

— A, kush qenka! — tha ai me buzëqeshje të ëmbël. (A. Abdihoxha, Endërra, 102); — Po Kliu? pyeti Halimi. — E, mor Andon, — qeshi Vasili. Kush pyet për Klinë, a derëbardhë? (P. Marko, Halimi, 189); — S'jam martuar! — tha plaku që i mbante duart përpara në vehten e tij. — E, se do të të martojmë ne, i thosh Pucelli. (P. Marko, Hasta, 298); — Iii, ja bëri ajo me zë të hollë, iii mor im-zot, si arthkam unë në mes të burrave! (M. Kuteli, Kapllan Aga, 24); O sa bukuri ka tufa, Sa gas bie bagëtia (N. Frashëri, Bagëti, 4); — U, pika të rëntë ty! ia bëri plaka dhe i dha munxat. (D. Agolli, Komisari, 190); — Y, or budalla, nuk ke frikë? (Folklor, 4, 148).

b) Një a më shumë tinguj bashkëtingëllorë: s, sh, st, sht, pst. Pasthirrmat që përbëhen vetëm nga tinguj bashkëtingëllorë janë të rralla. Kemi ndeshur vetëm pesë. Katër nga këto (s, sh, st, sht) përdoren për të shprehur urdhër a nxitje për vendosjen e qetësisë dhe shqiptohen me bashkëtingëlloren s e sh të zgjatur. P.sh.

— Hë, çfarë thotë? — ja priti ai me çifte. — Sh-sh, ja ktheu portieri. (A. Abdihoxha, Tri ngjyrat, I, 121); — Sssst! — ja bëri Nuredini, duke vënë gishtin në buzë e duke përgjuar nga dera gjysmë e hapur. (Q. Buxheli, Kur qesh, 7); — sht, e zezë... — gruaja vuri gishtin në buzë. (F. Arapi, Patat, 39).

Por në letërsinë artistike përdorim më të gjerë ka forma «shët», shpesh me zanoren ë të zgjatur. Krahaso: — Shëët! — tha Xhuxhuku. Po humbasim kohën kot! (Gj. Zheji, Pupagjeli, 112).

Pasthirrma «pst» përdoret për thirrje, sikurse pasthirrma «ej», por me qëllim që, zakonisht, të tërheqim vëmendjen e atij apo të atyre të cilëve u drejtohem, pa rënë në sy të të tjerëve. Përdoret rrallë veçanërisht në letërsinë artistike. P.sh. Kujtimi: Sidoqoftë, jo aq sa unë... Punëtorja e dytë: Pst! (A. Mamaqi, Para fillimit, 30).

c) dy tinguj zanorë: *au, eu (heu), oi, ou, ua*. P.sh.

— *Au!* . . . u dëgjua një klithmë e zemëruar dhe e egër. (J. Xoxa, Juga, II, 493); E di unë pastaj, se ku do të na nxjerrë ajo kartë. *Eu*, sa kam hequr unë nga të tilla marrëzira! (S. Spasse, Buzë, 240); *Dashuri, heu!* mall i ri! (L. Poradeci, Ylli, 94); — *Oi*, kaq e lodhur paske ardhur moj nuse, sa të mos ngrehësh sytë nga pjata? . . . (J. Xoxa, Juga, II, 230); *Ou!* Fushek! Të duken shumë? (S. Çomora, Inzheksione, 56); — *Ua!* Ti qënke? S'më vente mëndja për njëqind vjet — pëshpëriti me frymën që i merrej. (Sh. Musaraj, Para, I, 355).

ç) tingull zanor + tingull bashkëtingëllor: *ah, eh, ej, ih, oh, oj, of (hof), or, uh, uf, uj*. P.sh.

— *Ah*, mor çun, pse plakë më bën ti mua? . . . (A. Abdihoxha, Një vjeshtë, 67); *Eh!* luftë moj nëne. . . edhe vriten. . . edhe plagosen. (Z. Sako, Nga jeta, 26); *Ej*, — mendoj — sa ferra e gjemba ka njeriu akoma në mendjen e tij! (T. Laço, Rruga, 14); — *Ih!* S'e vë dot në gojë! Bie erë! (Gj. Zheji, Pupagjeli, 13); *Oh*, edhe tani më dhemb zemra, vëlla Sadik, kur kollën tënde sjell ndërmend. (A. Çaçi, Legjenda, 3); — *Oj!* Na u ankua zotëri' e tij se ka ecur tri orë në këmbë e ka fjetur një natë në shesh. (Sh. Musaraj, Para, II, 156); *Of*, i gjori unë, i varfri unë! Pse s'e dëgjova vëllanë? (M. Kuteli, Xinxifilua, 146); *Rent, or rent, rent* e u thuaj Se u çthur ordi e huaj. . . (F. S. Noli, Album, 65); *Uh*, sa më trembe. (S. Spasse, Kurora, 117); *Uf*, aman Sterjo. . . ç' thua. . . — dhe ra në lejë të arës si fije bari e prerë nga kosa. (N. Prifti, Çezma, 4); — Do vini në qytet? — *Uj*, posi, për atje presim, ja pa shih. (K. Kosta, Bisedë, 141);

d) tingull bashkëtingëllor + tingull zanor: *ba, bo, bu, pa (pah), hə (hëni), hy, pu (puh), py*. P.sh.

Asnjë shqiponjë nuk kish mbetur. Vështron përposh, njerëzit i dukeshin sa një mizë. Provon litarin që të zbriste, *ba!* Litari ishte shumë i shkurtër. (Folklor shqiptar, Proza, IV, 563); Kur kallamat u hapën dhe gjahtarët dolën në sheh, mallakastrioti klithi: — *Bo*, ç'kopera të mrekullueshme. (J. Xoxa, Juga, I, 467); — *Bu!* Pse foshnjë më bërë ti mua? (M. Kallamata, Netë, 105); Dhe kur shkuam në plazh për të bërë muajin e mjaltit. . . Na shihnin njerëzit dhe thoshin: «*Pa*, çfarë çifti! Sa të lumtur që janë!» (K. Blushi, Drama, 195); *Hë*, qerrata, ishe mësuar me qoftet e Sali Protopapës ti — t'ia komandanti Rrapo dhe gjithë partizanët qeshën. (D. Agolli, Komisari, 264); Vita hodhi një vështrim të shpejtë në dhomë, pa flokët e së bijës mbi krevat e në dysheme dhe e kuptoi ç'kish ngjarë. — *Hy*, të preftë Perëndia ditët. (N. Prifti, Një pushkë, 117); Marga — (në shtëpi) *Pu*, ç'gënjen maskarai! (L. Papa, Drama, 87); Hodhi me zor disa hapa gjer te dera dhe mbeti duke rrotulluar tej këtej ca sy të frikshëm e duke thënë: — *Pyyy* si më duket bota! (A. Kristo, Shkëndijat, 48);

dh) tingull bashkëtingëllor + tingull zanor + tingull bashkëtingëllor: *bah, hej, hop (hopa), moj, mor, sus, tyt*, P.sh.

«*Bah!* — ia pat me vete, — ja ç'do të thotë familje në komunizëm!» (A. Abdihoxha, Një vjeshtë, 72); *Hej*, njihuni me poezinë time të fortë. (V. Skënderi, Vjersha dhe poezi, 61); — Djem, *hop!* e djemat *hop*, në këmbë! (D. Agolli, Mesditë, 70); — Do të bëjmë zhurmë zallit, thotë një herë Hajdëri, pastaj mendohet e vendos: — Mirë, nën urë. *Hopa!* (Dh. Shuteriqi, Çlirimtarët, 7); More vesh, *moj?* (A. Abdihoxha,

Tri ngjyra, I, 170); *Mor*, po ato ato pushkë ç'qenë? . . . pyeste ndonjë, duke e sjellë bisedën prapë atje tek ishte nisur. (J. Xoxa, Lumi, II 183); — *Sus*, qen! . . . bërtiti së dyti beu e u dha një kamzhik duarve të mbërthyer pas degëve. (J. Xoxa, Lumi, 541); — *Tyt*, moj teveqelja e shëndoshë! A përnjimend s'po e njeh, a? (F. Ndocaj, Diell, 203);

e) tingull zanor + tingull bashkëtingëllor + tingull zanor: *aha*, *ahu*, *ama*, *ehe*, *ehu*, *eja*, *oho*, *ohu*, *ore* (*more*), *ori* (*mori*). P.sh.

— *Aha!* Për vete nuk pyet kurrë ai, o çupë e xhaxhait. (S. Pitarka, Heronjtë, 50); — *Ahu*, ty, po, kalendari tridhjetetë të rri, tërmonë. . . (J. Xoxa, Juga, I, 220); — *Ama*, për këto na prure që menatë këtu? — thosh Pucelli. (P. Marko, Hasta, 296); — *Ehe*, u bëre matuf u bëre! T'u errësuan sytë. Nuk e njeh Renaton? — i fliste Morrettua. (P. Marko, Hasta, 413); *Ehu*, ç'burrë paske pasë ndërmend me marrë, o e shkretë, (K. Jakova, Halili, 16); — *Eja*, *eja* nisemi shpejt! Shpejt. . . Të paktën të dalë edhe ndonjë shqiptar i gjallë. . . *Eja!* *Eja*, mor bir. . . (P. Marko, Hasta, 356); *Oho*, o mik i dashur, me sy sikur t'i shihnje, tek vinë trumba-trumba të çelur e gazmorë. (L. Qafëzezi, Proletarët, 116); *Ohu*, pozicioni është gjëja më e lehtë. (Q. Buxheli, Kali i mbretit, 12); *Ore*, po ky qenka qorr. (F. Gjata, Tana, 52); — *Ou* — ç'thotë — si s'ma kini rujtë ju *ori*, se ajo ka qenë e vogël. (Folklor shqiptar, Proza, III); — I kujt je ti, *more?* — s'iu durua më në fund pa pyetur vajzës. (Sh. Musaraj, Para, I, 98); Do zërë të bjerë për së dyti dhe ja shtrojmë nga pika e parë. *Mori*. . . *Ti!* — thirri. (T. Laço, Toka, 346).

Këto pasthirrma përdoren edhe të përsëritura (dy herë, tri herë ose më shumë). P.sh.

U! U! Kola! *Eja*, xha Kola, *eja!* (P. Marko, Hasta, 9); *Ah!* *Ah!* Përpara më thoshe doktor efendi, tani qënkam vetëm zot! (A. Z. Çajupi, Baba-Tomorri, 135); — *Oh. . . oh. . . oh!* kënaqej Kasemi. — *Kjo* është jetë! . . . (B. Lëvonja, Ditari, 35); *Oj, oj. . .* na shitka dhe mënt. . . *oj, oj. . .* (J. Xoxa, Novela, 132); — *Pu, pu, pu. . .* si ta nxuri goja gjithë këtë fjalë moj korbë! . . . u hodh priftëresha, që ishte hequr më një anë e zemëruar. (J. Xoxa, Lumi, I, 13).

Në disa raste kjo përsëritje është bërë shkak për përngjitjen e tyre dhe për pasurimin, në këtë mënyrë, të fondit të pasthirrmave të shqipes me formime të reja. P.sh.

— *Bobo*, sa keq qenka të shohësh kallinjt e arat të roniten përpara teje. . . (S. Spasse, Ata nuk ishin, 48); *Bubu!* Ah vasha qan me lot, Moj Motrëza bujare! (L. Poradeci, Ylli, 57); Posa pa kështu kulçedra, *popo!* tha, nga ky njeri s'kam shpëtim unë. (Instituti i Foklorit, Mbledhës, 170); *Pupu*, sa e bukur! Shiko, shiko si ndrit «*fap, fap*». (M. Zaloshnja, Nën hijen, 90).

Shpesh pasthirrmat që përbëhen nga një tingull zanor dhe ato që përbëhen nga dy a më shumë tinguj, i gjejmë të kombinuara a të përngjitura me njëra tjetrën, duke pasuruar kështu fondin e pasthirrmave të gjuhës sonë me formime të reja. P.sh.

Tefiku: Ah, këta partizanë të mallkuar! Po ç'u marrosën kështu? Ç'i zuri që u tërbuan? Thanasi: *Hë de*, ç'i zuri! (V. Kokona, Hijet 28); *Hënde de*, na e trego se për meselera jemi mbledhur. . . (M. Kallamata, Netë, 58); — *Hëndede*, xha Trifon nga e zuri Rrakullën ky, nga

Pindi apo ja la trashëgim Idriz beu? (J. Xoxa, Juga, I, 31); *Olele*, më vranë, më mbytnë! — përpëlitet Ngjela dhe mundohet të shpëtojë. (S. Spasse, Ata nuk ishin, 255); *Obobo*, seç qenka Kota, Bytym mitraloz'e topa! (Instituti i Shkencave, Këngë, 300); Moj shishea vija vija, *ohoho* ç'qënkej rakia, për të marrë mënt e mia. (Instituti i Folklorit, Mbledhës, I, 309); *Opopo!* ç'më gjet! o shokë, Do të qanj me thes në kokë. (N. Frashëri, Luletë, 66); Qani gjithë Shqipërinë, Toskërinë, Gegërinë, *Ububu!* ç'humbi lirinë. (L. Poradeci, Ylli, 25).

Pasthirrmat e grupit të dytë formohen nga fjalë të pjesëve të ndryshe të ligjëratës, të cilat në raste të tilla, shqiptohen me ngjyrë të fortë emocionale a shprehëse dhe humbasin a dobësojnë kuptimin leksikor. Krahaso:

Në këmbë, *o burra* të Labërisë, për jetën tonë, për nderin tonë, për lirinë tonë, për Shqipërinë tonë, për Vlorën tonë. (P. Marko, Nëntori, 7, 1970, Guna mbi tela, 105); *Qyqja* hap krahët, ngrihet nga dega e thatë e ahut, fluturon drejt në Jutbinë. (M. Kuteli, Xinxifilua, 190);

— Depot janë plot ushqime! — *O burra*, në gazerma! (A. Kristo, Shkëndijat, 537); — *Qyqja!* E shkreta Zyra, çka për të hequr me të. (M. Kallamata, Netë, 96).

Në dy shembujt e parë «*o burra*» dhe «*qyqja*» janë emra dhe si të tillë ruajnë kategoritë leksiko-gramatikore përkatëse, ndërsa në dy shembujt e fundit, po këto fjalë, por në formë të ngurosur, pa kategoritë leksiko-gramatikore përkatëse dhe me intonacion të veçantë, janë pasthirrma, pra kanë kaluar në fjalë të një kategorie tjetër leksiko-gramatikore.

Në këtë grup pasthirrmash hyjnë disa forma të ngurosura të emrave, ndonjëra e shoqëruar me pjesëzën përforcuese *o*, me mbaresën *-ni* të foljes në mënyrën urdhërore ose me të dyja njëherazi (*o burra*, *o burrani*, *forca*, *forcani*, *korba*, *qyqja*, *vaj*, *o zot*, *o perëndi*) si dhe disa mbiemra të substantivuar. P.sh:

Perëndia, si gjer tani, ashtu edhe paskëtaj do të na ndihmonjë e do të na nxierë faqebardhë. «*O burrani*» (F. S. Noli, Historia, 108); *Forca*, — thërrisnin dhe djersët u shkonin çurg. (D. Shaplllo, Kohë, 26); Dera e udhës trokiti. — *Korba!* u drithtua plaka e u gjet në këmbë. (Dh. Shuteriqi, Çlirimtarët, I, 158); *Vaj!* Vëllaj i madh e shkeli besën e fjalën. Kuvëndoi në shtëpi. i tregoi vashës së vet kështu e kështu, i tha të mos vinte atje të nesërmen. (M. Kuteli, Tregime të moçme, 14); Ismaili e vështronte herë pas here me bisht të syrit: o Zot, sa i shëmtuar që ishte! Sa të madhe që e kishte kokën. (V. Kokona, Me valët II, 125); *O perëndi!* Ju, pikërisht ju, që pas një viti do të merrni diplomën e mësuesit, kaloni kohën me çikërrima të këtilla?! — thirri ai duke zgjatur dorën e bardhë. (A. Abdihoxha, Tri ngjyrat, II, 416); *E zeza*, na dogjët shtëpinë e vëllait. *E zeza!* (D. Shaplllo, Kohë, 28); — Hajde, Violcë, të keqen! (A. N. Mara, Brumi, 144).

Mbaresën *-ni* e marrin, kryesisht në gjuhën e folur (në thjeshtligjërime), jo vetëm disa forma të ngurosura të emrave që përdoren si pasthirrma, por edhe disa pasthirrma të tjera, të parme e të prejar dhura, që përdoren për të shprehur dëshirën a vullnetin e folësit (p.sh. *hajde-hajdeni*, *hë-hëni*, *eja-ejani*, *aman-amani*) ose përsëritje të ndry-

shme (p.sh. *mirëmëngjes-mirëmëngjesni, mirëmbërëma-mirëmbërëmani; mirëdita-mirëditani, tungjatjeta-tungjatjetani*).

Këtë mbaresë e marrin vetëm pasthirrmat urdhërore, kur u drejtohem dy a më shumë frymorëve (ose një frymori të vetëm, të cilit i drejtohem me «ju») për ta dhënë më mirë idenë e shumësit. Pasthirrmat emocionale në përgjithësi nuk përdoren me këtë mbaresë foljore, edhe kur janë formuar nga forma të ngurosura të kategorive të ndryshme leksiko-gramatikore (*qyqja, korba* etj.), pra edhe kur nuk janë të parme. Ndërkaq duhet vënë në dukje se trajtat me mbaresën *-ni* s'janë letrare. Ato ndeshen rrallë në gjuhën e folur dhe akoma më rrallë në gjuhën e shkruar. Kur u drejtohem dy a më shumë frymorëve, si në gjuhën e folur, ashtu edhe në atë të shkruarën, zakonisht përdoren trajtat pa mbaresën *-ni*.

Disa pasthirrma të prejardhura janë formuar nga bashkime të qëndrueshme frazeologjike (*djall o punë, dreq o punë, dreqi ta hajë, hej dreq, më qafsh, qoftë larg, punë e madhe, t'u bëfsha*, etj.). Në këto bashkëlidhje (togje) fjalësh⁴³, me kuptim tërësor dhe me përbërje e strukturë të qëndrueshme, të gjitha pjesët (gjymtyrët) ose pjesërisht përdoren me kuptim jo të lirë. Këto bashkëlidhje funksionojnë në gjuhë si ndërtime të mëvetësishme, që nuk formohen aty për aty lirisht në procesin e të folurit, por riprodhohen si njësi të gatshme të sistemit gjuhësor dhe shprehin si tërësi ndjenja të ndryshme. Nga pikëpamja semantiko-funksionale, pra, janë të barazvlershme me pasthirrmat. P.sh.

Dreqi ta hajë, mirë thonë arabët: njerëzit verën e dërgojnë në bark, kurse ajo u shkon në kokë (N. Jorgaqi, Dashuria, 162); *Punë e madhe*, nuk shikon? (E. Kadare, Një lindje, 205); *Eja, eja, t'u bëfsha*, se plasa! (P. Marko, Hasta, 343); *Larg qoftë!* tha nëna. (Dh. Shuteriqi, Gurnecka, 42); *Eja me mua, eja, më qafsh*, mos i folë babajt dhe vëllajt. (V. Kokona, Hijet, 63).

Në këtë grup hyjnë gjithashtu edhe ato pasthirrma që janë formuar nga përsëritja e formave të emrave, ngjanjëherë me temë të cunguar, që përdoren zakonisht për të ndjellur, për të ndërsyer a për të frikësuar kafshët shtëpiake (*pul-pul, pat-pat, cap-cap, giç-giç, kuç-kuç*). P.sh.

-- Tëk-tëk! Tëk! Tëëëëk! *Pul-pul!* Eni, eni më lart. (P. Marko, Hasta, 414); *Qingji si kërthi hofën e ban naze!* Ngado që të shkoj / Nuk më ndahet hiç. E due e lëmoj / E ndiell *giç-giç-giç*. (Q. Guranjaku, Xixëllonjat, 52).

Në grupin e dytë të pasthirrmave do të përfshihen edhe një numër të vogël fjalësh-pasthirrma, që janë huazuar nga gjuhët e tjera. Shumica e tyre janë huazime orientalizmesh: *aman, de (deh), allah, allahalla, meazallah, mashalla, hajde, medet, sikter, shyqyr*⁴⁴. Përgji-

43) Androkli Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e Fjalorit të gjuhës shqipe*, «Studime filologjike», Nr. 2, 1968, 82.

44) Në shumicën e gramatikave të shqipes gjejmë, ndërmjet shembujve, edhe fjalë-pasthirrma të huazuara: Sami Frashëri (*vepër e cituar*, 133) — *deh*; Gjergj Pekmezi *vepër e cituar*, f. 217) — *aferim, allah, aman, bre (breh), de, medet, (aman dhe medet i vlerëson me prejardhje turke)*; Anton M. Xanoni (*vepër e cituar*, 166) — *bre*; G. Mikeli (*vepër e cituar*, f. 124) — *aman, de, medet*; Ilo Dilo Sheperi (*ve-*

thësisht pasthirrmat e huazuara kanë përdorim të kufizuar. Ato, sidomos orientalizmat, janë mënjanuar e po mënjanohen me të drejtë e gjithnjë e më tepër për shkak të përdorimit të fjalëve e sidomos të pasthirrmave të gjuhës sonë: *alt, stop — ndal; aman — të lutem, të keqen; bravo — të lumtë; allah, allahalla — o zot, çudi, oh, ua; meazallah — bah, pupu; medet — bobo, bubu; pardon — më fal; sikter — y, qërohu, shporru, ikë; shyqyr — oh, faleminderit; jazëk — turp, y* etj. Shumica e orientalizmave përdoren në gjuhën popullore, kryesisht në brezin e rritur, dhe, në ndonjë rast, thuajse janë zhdukur fare: *afërim — të lumtë, evallah — faleminderit* etj. Pasthirrmat e tjera (*alo, alt, bis, bravo, marsh, pardon, urra*) janë huazime relativisht të reja, kryesisht të këtij shekulli, që zakonisht përdoren në sfera të përcaktuara P.sh.

ALO (anglisht *hallo*).

Përdoret për thirrje, si sinjal, pa dallim seksi, në bisedat telefonike në kuptimin *dëgjoj, dëgjoni*. P.sh.

— *Alo!* — tha ai, duke shtërnguar fort receptorin. (Q. Buxheli, Kur qesh, 41); — *Alo, Tirana! Alo! Alo! Tirana!* (Dh. Shuteriqi, Çlirimtarët, II, 27); Forma me *h* nistore (*halo*) ndeshet akoma më rrallë si në gjuhën e folur ashtu edhe në letërsinë artistike.

ALT (gjermanisht *alt*) **STOP** (anglisht *stop*).

Janë thirrje profesionale që përdoren në kuptimin *ndal, mjaft, mjafton*, pra për të shprehur një komandë a urdhër me qëllim që të përfundojë veprimi i dhënë. Këto pasthirrma nuk janë përhapur në gjuhën e folur e të shkruar. Si sinjale a komanda të caktuara (*alt* në ushtri dhe *stop* në transport e PTT) thuajse kanë dalë nga përdorimi. Në letërsinë artistike i kemi ndeshur shumë rrallë. P.sh.

— *Alt! Alt! Alt!* thërret patrulla e bën gati pushkën që të shtjerë. Dy vetë duken e zhduken te një rrugicë tej. — *Alt!* thërret patrulla e shtije n'ërë... (Dh. Shuteriqi, Çlirimtarët, II, 6); — *Alt!* — u dëgjua në qetësinë e maleve (A. Kondo, Njerëz dhe gurë, 21). Këtë pasthirrmë herë-herë, sidomos në letërsinë artistike, e kemi ndeshur edhe në formën *halt*.

Petriti — *Stop! Stop! Stoop!* Zëri i Metit — Çfarë ke, more? Petriti — Këtu nuk kalohet! Xha Nisi — (Duke hyrë, drejton me dorë) Hajde, hajde hidhni sytë mirë. *Stop!* (Petritit) Doli. Kaloi! (Maqina e Metit shuhet). (K. Blushi, Drama, 59); «*Djathtas!... Edhe ma djathtas!... S'asht mirë!... Pak majtas!... Edhe pak... Stop!*» (S. Su-

për e cituar, f. 125) — *aman, urra*; Aleksandër Xhuvani (*vepër e cituar*, f. 129) — *bre*; Kostaq Cipo (*vepër e cituar*) — *aman, hajde*; Shaban Demiraj (*vepër e cituar*, f. 295-296) — *aman, bravo, hajde, medet, urra*; Petër Elezi—Lirak Dodbiba (*vepër e cituar*, f. 16) — *bre* (në ushtrime f. 172 ndeshen edhe *bravo, urra*); Shaban Demiraj—Nikoleta Cikuli (*vepër e cituar*, f. 325) *urra, bravo, aman, hajde*. Fjalëve-pasthirrma të huazuara u është dhënë më shumë vend në gramatikën e Gustav Weigandit (*vepër e cituar*, f. 99,100). Pasthirrmat turke ai i ka vendosur në një grup më vehte: «*aman* (mëshirë), *ewalla* (lamtumirë, faleminderit), *shykjyr* (lavdi zotit, faleminderit), *peki* (bukur), *sikter* (ikë në djall), *jalla* (ja allah)», por ndërmjet grupeve të tjera të pasthirrmave gjejmë edhe këto fjalë-pasthirrma të huazuara: *afërim, bravo, bre, medet*, (*afërim* e *medet* i vlerëson gjithashtu me prejardhje turke). Në gramatikat e hartuara nga Kostandin Kristoforidhi, Koço Tasi e Osman Myderrizi, *vepra të cituara*, nuk ndeshim fjalë-pasthirrma të huazuara.

lejmani, Njerëzit, 73); — Krahu i djathtë, *stop!* Kjo klithmë e tij ndaloj të dy rremtarët e krahut të djathtë përpara se ata të kuptonin përse duhej ky *stop* (K. Blushi, Vdekja e një nate, 173).

AMAN (AMANI)

Kjo pasthirrmë, sidomë është mjaft e përhapur, si në gjuhën e folur ashtu edhe në gjuhën e shkruar, nuk përbën normë. Përdoret sidomos për lutje, përgjërime, mëshirë. Është sinonime me pasthirrmat të lutem, të keqen. P.sh. I vate pranë atij burrit e i thosh: — More, po thuamë, thuamë, *aman*, pse i bie këtij varri me shkop? Aty s'ka njeri. Ai është i vdekur! (Foklor shqiptar, Proza, 530); — *Aman*, Mira, na e lexo me zë! S'duroi dot njëra nga gratë. (E. Kadare, Një lindje, 149); — *Aman*, mos ma kujto. (I. Kadare, Kështjella, 235).

Kjo pasthirrmë përdoret edhe me mbaresën *-ni*, kur u drejtohem dy a më shumë personave. Në raste të tilla dy bashkëtingëlloret e njëjta *n* (*n* e temës së fjalës dhe *n* e mbaresës *-ni*) paraqiten me një shkronjë. P. sh. Kam një rixha, *amani*, na gjeni ca fishekë austrie! (Th. Kacori, Për mëmëdhenë, 145); — *Amani* more, mjaft, mjaft!... thërriste spiuni. (P. Marko, Halimi, 152).

Por kjo pasthirrmë përdoret edhe për të shprehur ndjenja të ndryshme, sidomos frikë, pakënaqësi, përbuzje, mospërfillje. P.sh. — *Aman* si më rreh zemra, pa vër një çikë dorën, — i tha ajo! (N. Prifti, Çezma, 96); Më në fund, Piloti e hypi në elikopter dhe Burdullaku, dyllë i verdhë nga frika e i mbytur në djersë, u bashkua me shokët në dysheme. — *Aman*, mor burrë, çfarë frike! — tha. (Gj. Zheji, Pupagjeli, 9); — Dëgjo këtu ti, se kam pa një andërr unë që *aman*. (R. Likaj, Nëntori, 10, 1968, 72); — *Aman*, ç'njerëz. Sikur këtu të ishte han dhe jo institucion shëndetësor. (E. Kadare, Një lindje, 143); — *Aman*, me këto gratë! — u dëgjua në koridor zëri i rreptë i Lumtos. (E. Kadare, Një lindje, 268); — *Aman*, të ikë një sahat e më parë. (D. Agolli, Komisari, 106).

Shpesh, për të shprehur ndjenja (sidomos habi, frikë) dhe për intensitet kjo pasthirrmë përdoret edhe e përsëritur ose në shprehjen *aman o zot*. P.sh. kur i jepte asaj së shkrete lopatë si përkulej e si rrëgohej *aman, aman*. (N. Prifti, Lëkura, 3); Më parë, ky vend këtu mbrapa «Sheshit të Flamurit» që sot duket kaq i bukur, ka qënë një shesh që *aman-aman*, me nja dy barranga shkatarraqe, plot pluhur (B. Muha, Ylli, 31); Krisi atë kohë një patare e madhe që *aman o zot*. (J. Xoxa, Novela, 19); — Ç't'ju them, moj korba, ç'u bë atje, atyre u qoftë. Një kujë e një llahtari, që *aman o zot*. (I. Kadare, Qyteti, 21).

BIS (latinisht *bis*=dy herë)

Kjo pasthirrmë ka përdorim shumë të kufizuar. Me të shprehet kërkesa për të përsëritur diçka (zakonisht një këngë, ndonjë pjesë a numër që sapo është luajtur). P.sh.

— Edhe një herë! — vazhduan të thërrasin fshatarët, kurse disa nxënës të shtatëvjeçares ja bënë: — *Biss! Biss! Biss!* (S. Spasse, Buzë, 6); Unë hypja në shkallë dhe këndoja. Ata duartrokisnin dhe thërrisnin: «*Bis! Bis!* (P. Zoto, Shqiptarja, 18).

Këtë pasthirrmë e gjejmë herë-herë edhe në formën *biz*, si në gjuhën e folur ashtu edhe në letërsinë artistike.

BRAVO (italisht *bravo*)

Përdoret për të shprehur lavdërim, miratim, nxitje, entuziazëm, admirim, gëzim. Mund të përdoret edhe për ironi a tallje. Si në gjuhën e folur edhe në gjuhën e shkruar përdorimi i saj është zgjeruar në vend të pasthirrmës shqipe «*të lumtë*», në kuptimin e së cilës përdoret. P. sh.

— *Bravoo!* — e lavdëroi mësuesja duke i përkëdhelur flokët. (S. Spasse, Afërdita përsëri, 211); — *Bravo*, djalë i babës, — bërtiti Rroku. E solle kafënë moj? Kam djalë, jo shaka. (I. Spasse, Cuca e pavionit, 142); — *Bravo!* — brohoritën disa zëra të tjera. (S. Spasse, Afërdita përsëri, 211); — *Bravo!* — tha Muhameti, duke përplasur duart. (Q. Buxheli, Kur qesh, 252); *Bravo*, xha Tirkë, *bravo!* — iu dha të thotë Miti Llafazani. (S. Spasse, Buzë).

Këtë pasthirrmë e gjejmë në ndonjë shprehje të shoqëruar me trajtat e shkurtëra të përemrit vector në rasën dhanore të ndjekur nga folja jam në kohën e tashme të mënyrës dëshirore, veta e tretë, numër njëjës, Këto shprehje kanë kuptimin *i lumtë, të lumtë* etj. P.sh.

— Kurse ai u jep kurajë me atë qëndrim që mban, — tha Ristua? — *Bravo i goftë!* (A. Kristo, Shkëndijat, 15); — Unë? Oj! S'të ka folur për mua? *Bravo i goftë!* (K. Blushi, Pjesë teatrale me një akt, 93). Në këto raste shprehja mund të përdoret edhe për ironi.

Ndonëse rrallë, pasthirrmën *bravo* e gjejmë edhe me mbaresën *-ni*, kur u drejtohem dy a më shumë personave. P.sh. Pastaj mbreti u tha «*bravoni*» (Mbledhës, 1635-1912, 279).

BRE

Përdoret zakonisht për të shprehur ndjenjë habie. Herë-herë ndeshet edhe forma *breh*. P.sh.

Bre! Po paske bërë kërdrinë! (M. Kallamata, Netë, 77); «*Bre-e, bre!* — çuditej Vasili me vehte. (A. Abdihoxa, Një vjeshtë, 98); *Bre! Bre! Bre!* habitej një fshatar disi i kaluar nga mosha, që kish një setër e një palë bollka shajaku tërë zhele. (F. Gjata, Përmbysja, 289).

Shpesh pasthirrma *bre* është sinonime me pasthirrmat *ore, more, moj* etj., sidomos kur përdoret me funksion përforcues, për të rritur fuqinë shprehëse të të folurit a për të nënvizuar kuptimin e fjalës e të fjalisë përkatëse. P.sh.

A thue doli bjeshkët për me i ndritë, a shtegtarit zemrën me ja ndezë, kah suvali flokët farfuri, kah i jep *bre* shtatit, porsi sustë? (T. Miloti, Zanusha, 7); — Çfarë tamblit don me marrë, *bre!* — ia kthen Bokshiqi. Janë mundue dragojt me e marrë e nuk kanë mujtë. (Folklor shqiptar, Proza, II, 243);... Kurse kjo, kjo puthej me djalin e botës dhe kukurisej mezhdave! Ku ish ai pus, *bre*, që ta mbyste me duart e tij. (Dh. Shuteriqi, Kënga, 199).

Kjo pasthirrmë ka përdorim të gjerë në këtë vështrim para thirrurit dhe pas pjesëzave *po, jo, mos*. P.sh. — Cilin po tall, *bre* ti? (S. Çomora, Inzheksione, 8); — *Ej, bre* djem, më duket se do t'ju vejë puna dëm — tha një plak. (T. Laço, Rruga, 15); Sa shpejt *bre* burra kthyet nga qabeja? Na dogjme duert, ju vrap n'gështenja. (Sh. Musaraj, Epopeja, 24) Dukesh si i mërzhitur, — tha përsëri i panjohuri.

— Jo, *brei* (S. Xhai, Kur nder-tohej, 7); Mos, mos *brei* — tha plaka Marteja e Ndre Gjergjit. (Ll. Papa, Zeri, 13.V.1967); — Ene cuca ime a komuniste. Po, brei! Komuniste e bone vjetin e kaluem. (Xh. Abazi, Drita, prill 1969);

Kete pasthirme here-herë e kemi gjetur në formën *dre* dhe *breh*. P.sh. — *Dre, dre!* Pse, ore, tani natën e kërkon kismetin ti, a? (P. Jusuti, Perrenjtë, 76); Kaq bukur shkruajnë asaj Myzeqgeje? *Dre!* (Uh. Shuteriqi, Tregime 251); *Breh!* Ai ma të shumtën shkon me ra dejshe. (Instituti i Folklorit, Anekdotë, 263).

DE (DEH)

Përdoret për të shprehur ndjenja të ndryshme, si deshpërim, keqardhje, kënaqësi, gëzim. Në të tilla raste është e afërt nga kuptimi me pasthirmat *ah, oh, eh, hej* etj. P.sh.

— *Deh* mo! pike e zeze, *de!*... Edhe kur di g'korr, nuk di g'fut brenda, kashtë apo byk... — tunde koken për maraz të zemrës... (J. Xoxa, Novela, 119); *Deh*, mor, *deh!* g'e gjeti të shkretin djal pa pritë pa kuftue! (Lipi, Fatbardhi, f. 46); *Deh!* ç'u përhap rreth maleve kushtrimi. (N. Mjeda, Lissus, 127); Po bëjmë lutë *de mor de*, si lum ti popull me zi na ke! (Sh. Musaraj, Epopeja, 16); *Deh* i lumtë goja kush e tha më par' xhan e shpirt, o burrë, xhan e shpirt, o zjarr/ (A. Asllani, Hanko-halla).

Kjo pasthirme përdoret më shpesh për të rritur fuqinë shprehëse të folurit, për të nënvizuar kuptimin e fjalës e të fjalisë përkatëse. Në të tilla raste pasthirma ka kuptim nxites, është e afërt nga kuptimi e përdorimi me pjesëzën emocionale-shprehëse *pra* dhe *za-*konishtë përdoret në formën *de*.

— Thuaje, *de!* — ja priti Ahmet beu, (A. Abdihoxha, Tri ngjy-rat, I, 130); «S'e kish për herë të parë, *deh*, që po i pillte kjo e shogja...» (J. Xoxa, Lumi, I, 49); «Ashtu, *de!* — foli me vete. — Tashti e mbloodhi mendjen top!» (A. Abdihoxha, Enderra, 80).

ALLAH

Përdoret shumë rrallë, kryesisht në gjuhën e folur e në brezin e moshuar dhe më tepër në formë të perseritur (*allah, allah*) a të përngjitur (*allahalla*). Here-herë përdoret edhe forma *jalla (jallah)*. Zakonisht përdoret për të shprehur frikë ose gudi. P.sh.

Allah, medeti (M. Kallamata, Nete, 52); Haxhiu — *Allah, allah, g'vajt!* (N. Priti, Dasmë, 51); — *Allah, allah*, g'ka paskan ba. (S. Sulajmani, Njerezit, 176); — *Allahalla!* — bëri gudi Zela, e ndezi një fener të keq. (Dh. Shuteriqi, Çlirimtarët, 18); — *Allahalla!* shtangu Zela e u tremb. — Prishje e madhe! (Dh. Shuteriqi, Çlirimtarët, II, 19).

MEAZZALLAH

Përdoret zakonisht në gjuhën e folur, kryesisht në brezin e moshuar, më vlerën e pasthirrme *bah* a të shprehjes *larg qofte*, sidomos për të shprehur qëndrim mohues, kundërshtim, a diçka si të pamundur. Por gjithmonë e shogëruar me ndonjë ndjenjë, sidomos frikë e mos-përfillje. P.sh.

Pse do të thuash ti. Mos i ruhështa punës? *Meazalla!* Punë, ore, punë, ditë natë gjersa më dridheshin gjunjët nga të lodhurit. (S. Xhai, Premtimi, 156); — Trokasim të kjo dera këtu — propozoi Eda, duke treguar shtëpinë prapa tyre. — *Meazallah!* Ç'thua? Të alarmojmë

gjithë lagjen mendoke ti? (Sh. Musaraj, Para, II, 545); *Meazallah*, po të kishte ngjarë gjë, do kishin ardhur të na thoshin. (J. Xoxa, Lumi, II, 135); Po sikur *meazallah*, të mos çel unë këtu gojën, ç'do të thonë këta njerëz për mua? Si do të vriten fëmijët në zemrën e tyre të njomë?... (Dh. Shuteriqi, Këngë në minierë, 107); Këto të mallkuara dru, — tha ajo. — Kur i do, *meazallah* se marrin (E. Kadare, Një lindje, 22).

MASHALLA

Përdoret gjithashtu kryesisht në gjuhën e folur, zakonisht në brezin e moshuar, kur shohim një njeri, një kafshë a një gjë të bukur dhe duam që «të mos bjerë në sy». Në varësi nga konteksti shpesh shoqërohet me ndonjë nuancë të theksuar emocionale: habi, kënaqësi, admirim, ironi etj. P.sh.

Shpesh kjo pasthirrmë, në varësi nga situata dhe konteksti, përdoret për të shprehur thjesht habi. P.sh.

Sa e bukur na doli nusja! *Mashalla, mashalla!* (Mbledhës të hershëm, 396); *Mashalla*, vajzë paske, o Gurrëmadh! Shiko mos të ta rrëmbejnë shënpalasi! — ia bëri majori me të qeshur (S. Spasse, Buzë, 188); Ia ke bërë vithet, *mashalla*, naa, si kacek. (F. Gjata, Tana); *Mashallah!* Ka të drejtë plaku që nuk do të hyjë në kooperativë. (S. Çomora, Nga fshati i gruas, 10); Kalli gishtin kjo, iu kthye pastaj të birit me qesëndi, dhe na e bëri kosin, që... *mashalla*... (J. Xoxa, Lumi, I, 253).

HAJDE

Pasthirrmë mjaft e përhapur si në gjuhën e folur ashtu edhe në gjuhën e shkruar, megjithatë nuk përbën normë. Është sinonime me pasthirrmën «*eja*». P.sh.

— Jo — tha jevga — unë s'un t'rri pa çun! — Po *hajde* ne ti me gjithë burrin ke unë — tha mreti. (Folklor shqiptar, Proza, 131); *Hajde*, profesor, mbase gjejmë ndonjë kamion dhe vemi sonte në Tiranë. (M. Kallamata, Netë, 8); — *Hajde*, Bajame, *hajde!* U dëgjua Resmija, e cila doli nga soba e u drejtua për në ashef. (A.N. Mara, Brumi, 53);

Kjo pasthirrmë mund të përdoret edhe me kuptim nxitës, për fillimin e një veprimi. Në këto raste ajo është sinonime me pasthirrmën *hë*. P.sh.

— *Hajde*, vëllaçko, çohu, — se do të pastrojmë shtëpinë, — i tha duke hapur dritaren. — S'të mjafton nata po edhe ditën kërkon të flesh. (A. Kristo, Shkëndijat, 62); — *Hajde*, jepu krahëve, se nuk je bletë, de, që të harxhohen shpejt. (J. Xoxa, Juga, 162); — Ti mos shko! Vita me Lenin i dinë shtëpitë. Le të shkojnë t'i thërresin. *Hajde*, çupa, mos përtoni! — iu drejtua mësuesja. (S. Spasse, Afërdita përsëri, 212);

Sikurse pasthirrma *eja* dhe *hë* edhe pasthirrma *hajde* mund të marrë mbaresën *-ni*, kur u drejtohem dy a më shumë personave. Por me mbaresën *-ni*, si edhe sinonimet e saj *eja* dhe *hë*, përdoret më rrallë. P.sh. *Hajdeni*, çuna, kush ta hedhë gurin më fort! — tha Shpresa. (J. Xoxa, Juga, 154).

Pasthirrma *hajde* mund të përsëritet. Edhe në këtë rast shërben për të shprehur urdhër a nxitje. P.sh.

Luan, — tha ajo me një zë të përvajshëm si një fëmijë që e tremb *errësira*, *hajde, hajde*, ikim, — dhe e zuri për dore që ai të lëvizte nga

vendi. (N. Jorgaqi, Dashuria, 167); *Aspasia* — *Hajde, hajde*, lëri fjalët... Të gjithë kemi pasur turp kur u fejuam, por ty s'të falet se u fejove vetë dhe erdhe na e plase në shtëpi. (K. Blushi, Pjesë, 96); — *Hajde, hajde* ngrehu, të shikosh limonet e mi, që lulëzojnë njëmbëdhjetë muaj në mot. (J. Xoxa, Juga, 417); — *Hajde, hajde*, rri aty, se s'ja kemi ngenë të merremi me shakara! (P. Zoto, Verka, 45).

Por, kur përsëritet, kjo pasthirmë, mund të përdoret për të shprehur edhe ndjenja, sidomos çudi, përbuzje, mospërfillje. P.sh.

— *Hajde, hajde* si erdhi kjo dynja: Nelo Leckamani t'i japi strehë të birit të Drizës! — pëshpërisnin fshatarët. (S. Spasse, Afërdita përsëri, 253); «*Hajde, hajde*, sa budallenj paskërka këtej, më shumë se babaj e se nëna time» (Folklor, Proza, 70); *Hajde, hajde!* Është dhe nëpunës! (A. Kristo, Shkëndijat, 372); — *Hajde, hajde*, si arriu gjyqi... . . . Mua më zu goja lesh së foluri e ata më shkruajnë si fillim prove. Me të tjera fjalë ç'folat e ç'thashë shkuan në erë. (M. Kuteli, Fshati im, 16).

Në disa raste, e shoqëruar nga pasthirrma *de* në funksion përforcues, formon shprehje me kuptim miratues (*epo mirë*). Në këtë funksion shprehja përdoret edhe si një fjalë e vetme. P.sh. Je edhe plak me të shkretën, pa të ishe çun *hajde de!* (Sh. Musaraj, Isha unë, 86); Të rrëmbehej ndonjëri nga ne, *hajde-de*, se, siç na e ke thënë gjithmonë... (V. Vinçani, Të rinjtë, 33); Të ishte këtu në fshatin tonë *hajdedë*, po atje! U përmbys dynjaja, u përmbys! (S. Spasse, Buzë, 25); Mallkuar qoftë ky çast. Po *hajdede*. Edhe sikur të vijë ai çast, kur ti, or mik do të jesh i sigurtë, se e ke në dorë, unë do t'i bie violinës dhe do të këndoj. (S. Xhai, Nëndori 6, 111);

MARSH (frengjisht *marche*)

Përdoret si komandë a urdhër për fillimin e lëvizjes së një formacioni ushtarak. Ka gjetur një farë përdorimi në gjuhën e folur e të shkruar, por përgjithësisht ka përdorim shumë të kufizuar. Edhe në letërsinë artistike e gjejmë rrallë, zakonisht për të urdhëruar fillimin e shpejtë të një lëvizjeje (në kuptimin *nisu shpejt, ikë shpejt*). P.sh.

«*Gatitu, para marsh!*» (D. Agolli, Komisari, 197); — Ngarkohuni dhe *marsh* në brigadë! — urdhëroi Agimi. (F. Gjata, Brezat, 192); Dhe ata që do të kthehen në Barcelonë të dalin këtej... *marsh* (P. Marko, Hasta, 364).

Kjo pasthirmë përdoret edhe e përsëritur, *marsh-marsh* si komandë për lëvizje shumë të shpejtë, zakonisht duke rendur. P.sh.

I detyruan të bëhen cullak, si ç'i ka bërë e ëma, e i kërcënuan me revole: — *Marsh-marsh*, qena! (Dh. Shuteriqi, Çlirimtarët, I, 160).

MEDET

Përdoret kryesisht në gjuhën e folur, sidomos në brezin e moshuar. Shërben për të shprehur dëshpërim, dhimbje, keqardhje, frikë, tmerr. P.sh.

Medet, o shokë, *medet*, sos po vemi në kurbet, po nizamë për shtatë vjet... (Mbledhës, 27); *Medet!* Kjo zemra e njeriut sikur të jetë gatuar ashtu: të kthejë çdo tingull jetë në drithërimë dhëmbjeje (J. Xoxa, Lumi, III 178); Porse ja: shokët e djalit *medet*, nënën vinë e pjekin sy përlotur. (V. Skënderi, Këngët, 21); «*Medet*» thashë, «u vra Myslymi me gjithsejt!» (Dh. Shuteriqi, Çlirimtarët, 215); *Medet*

popullsia e atyre anëve. (H. Petrela, Kronikë 273); *Medet!* Armiku im është i fortë. (S. Andoni, Ylli, 1, 1967).

PARDON (frëngjisht *pardon*)

Përdoret shumë pak si në gjuhën e folur ashtu edhe në letërsinë artistike. Ndeshet kryesisht me kuptimin *më fal, kërkoj ndjesë*. Nganjëherë përdoret për ironi. P.sh. (Dallëndyshja duke dalë, përplasat me Skënderin që hyn). Dallëndyshja — *Pardon* (ikën). (D. Bubani, Drama, Bileta e llotarisë, 26); Ky lala i qenit po përçmon ligjet e shenjat të mbretërisë, *pardon*, t'imperatorisë. (J. Xoxa, Lumi, II, 248).

SIKTER

Përdoret për të shprehur urdhër, në kuptimin *ikë, qërohu, shporru, shko në djall* etj. Pra, zakonisht me këtë pasthirrmë i drejtojmë bashkëbiseduesit kërkesën për t'u larguar sa më parë, por me një ndjenjë të theksuar urrejtjeje, përbuzjeje, mospërfilljeje e zëmërimi. P.sh: Ç'ma mbani në krye atë ndyrësirë, atë tradhëtar! *Sikter!* (S. Spasse, Buzë 353); — Po ti, ç'i fut hundët atje ku s'duhet? Hajt! *Sikter!* Se ta këputa kokën! (F. Gjata, Në pragun, 178); Po ju, pa pushkë bre edepsiza, po na qitni nandëdhjetenandë telashe me komunistët, doni t'ju japim edhe pushkë... Hajt, *sikter!*... (Sh. Muşaraj, Para, II, 133); Nga më gjete gjysh ti mua? Në bostan? Hajt, *sikter!* (F. Gjata, Tana, 46).

SHYQYR

Përdoret rrallë në vend të fjalës *faleminderit*, por edhe për të shprehur ndonjë ndjenjë. Ka përdorim të kufizuar, kryesisht në gjuhën e folur, zakonisht në brezin e moshuar. E gjejmë shumë rrallë edhe në letërsinë artistike. P.sh.

— E or burra, si keni fjetur? — pyeti Islami. — *Shyqyr!* — shoku kryetar. (D. Agolli, Zëri, 27.2.1966); Myrtezai — Pleqtë tanë kështu kanë jetuar. Shpresa — Sepse nuk dinin. Myrtezai — *Shyqyr*, u bëtë ju të na mësoni. (Drama, 70).

URRA (sllave, kozak. *huraj*)

Përdoret si thirrje luftarake e trupave në sulm, por edhe si thirrje që shpreh entuziazëm, gëzim, admirim, miratim. Format me *h* në fillim ose në fund të fjalës, si në gjuhën e folur ashtu edhe në letërsinë artistike, thuhet nuk përdoren. P.sh.

— Në sulm! *Urmeta!* — *Urmeta!* — shpërtheu gjithë bregu i Piskupatit. (F. Gjata, Përmbysja, 409); — *Urmeta!* — thirri Kastrioti; e si shkrep prej qiejve moti lëshoi turr me arbënesh, u ba sheshi lamsh e pshesh. (K. Jakova, Garda, 90); — *Urmeta!* — thirri Çuçi. — Urime, shokë, për fitoren! (Q. Buxheli, Kur qesh, 132); — Rroftë Partiz Komuniste Shqiptare! — *Urmeta! Urmeta!*... (P. Jusufi, Përrenjtë, 155).